

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7842 E premte 5 Prill 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* **Ditës**

BRI, shkurtimi në anglisht i "Nisma Brezi dhe Rruga" ose "Një brez, një rrugë" (OBOR) përfaqëson projektin kinez më të madh në botë për ndërtimin dhe ...
Vijon në faqen 20

Nga JORGJI KOTE

Sfida e re e BE-së dhe Ballkani



Intervista *e* **Ditës**

Në Konferencën e Pranverës të Institutit vjenez për Studimet e Ekonomisë Botërore, që filloi dje (04.04) do të diskutohen ndryshimet demografike në ...
Vijon në faqen 21

Nga ISILDA MARA

Emigracion dhe popullsia në rënie, quo vadis Shqipëri?!



"Illyrian Guard" në varësi të Sandër Lleshajt

Policët e moshuar në prag të pensionit, krijohet agjencia "security" shtetërore

Edi Rama: Mundësi për efektivet që kanë rënie efikasiteti. Do të punojnë për ruajtjen e objekteve

Një javë më parë nga foltorja e Kuvendit, kryeministri Edi Rama u tregua kritik ndaj ministrit të Brendshëm për vonesat e sjelljes për miratim të një vendimi të posaçëm për krijimin e një kompanie të sigurisë së Policisë së Shtetit, e cila do të shërbente për sigurinë fizike dhe asaj të objekteve. Sipas Ramës, kjo lloj kompanie do të shërbente edhe si një "strehë" ...
Në faqen 5

TABELAT/ SHITESAT PER ÇDO KATEGORI, DIPLOMATET DERI NE 20% ME SHUME QEVERIA RRIT 7% RROGAT PER 65 MIJE VETA NE ADMINISTRATE

Ministrja e Financave, Anila Denaj: Ndryshimet në paga hyjnë në fuqi nga 1 prilli. Vendimi, ja institucionet shtetërore ku shtohen dhe pakësohen punonjësit



(Në foto) Kryeministri Edi Rama dhe ministret Elisa Spiropali, Olta Xhaçka dhe Anila Denaj, gjatë një seance parlamentare
Në faqen 8

SHKODER

Dhuna ndaj trajnerit Ernest Gjoka, flet i akuzuari: Më fyeu rëndë, e godita
Në faqen 7

SHIFRAT PROBLEMATIKE

Raporti i CRCA: 12% e fëmijëve janë pre e dhunës apo ngacmimeve seksuale
Në faqen 13

GUVERNATORI I BSH

Gent Sejko: Sistemi i sigurimit të depozitave në banka po forcohet
Në faqen 10

'SHWOBIZZ'

Velina e "Fiksit", Artea Beberi: Ekrani të bën personazh të dashur për publikun
Në faqen 14

FORMULA E SAKTE



Përlogaritja e pensioneve, ja koeficientët e rinj për indeksimin
Në faqen 12

KQZ-ja i jep mandatin, Korab Lita i PD-së deputeti nr.100 në parlament Basha: Mbështetje gjermane për qeveri të re

Rudina Hajdari, kritikëve: Keni 28 vjet që bëni politikë me Ruçin

Nga VALENTINA MADANI

Lideri i opozitës shqiptare, Lulzim Basha informoi parlamentarët gjermanë gjatë takimeve në Berlin se në Shqipëri, qeveria socialiste qeveris me kriminelët dhe se në Europë nuk shkohet me gënjeshtra, hile dhe



shtet të kapur nga krimi. Sipas tij në Europë shkohet me vlera kushtetuese ndërsa foli për dosjen '339', e cila dokumenton edhe vjedhjen e votës në parlament. Lulzim Basha, nga Berlina ku ndodhet në një vizitë për takime me parlamentarë ...
Në faqen 2-3

KRIZA POLITIKE ZGJIDHJA

Komisioni i jep mandatin, Korab Lita i PD-së, deputeti i 100-të në sallë

Debati, Gjuzi do mandatin nga KQZ-ja: S'do pres deri në fund të vitit

Sekretari: Ngele nëpër korridore çdo ditë

Valentina Madani

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i dha dje mandatin një tjetër deputeti në listën e Partisë Demokratike, i cili pritet të betohet në seancën e ardhshme parlamentare. Deputeti më i ri që i shtohet parlamentit është zoti Korab Lita nga lista e deputetëve për qarkun Tiranë. Me shtimin e tij, numri i deputetëve që ulen në sallë shkon në 100. Mësohet se ai ishte i 21-i në listën e deputetëve të PD për Tiranën dhe do të zëvendësojë ish-deputetin Dashamir Shehi në Kuvend. Kujtojmë që në seancën e kaluar të Kuvendit u betuan dy deputetë të rinj, Adriatik Alimadhi dhe Arben Elezi. Adriatik Alimadhi kreu i Ballit Kombëtar, ishte në listën e kandidatëve për deputetë të PD në qarkun e Vlorës në zgjedhjet parlamentare 2017. Alimadhi merr mandatin e Agron Shehajt, i cili u bashkuar vendimit ekstrem të opozitës së bashkuar. Ndërkohë, Arben Elezi i cili ishte në listën e kandidatëve për deputetë të PD në qarkun Elbasan merr mandatin e djegur të Edmond Spaho. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u përfshi dje në debate pas dorëzimit të formularit të dekriminalizimit nga Halim Jakimi, kandidati në listat e PD-së në Dibër, i cili kërkon mandatin e deputetit duke qenë njëherësh anëtar i Këshillit Bashkiak. Zv.kryetari Denar Biba u shpreh se nuk ka pse pret procedurat burokratike. Në debat u përfshi dhe anëtari i KQZ-së, Bledar Skënderi. "Kandidati për deputet nuk mund të penalizohet se Këshilli Bashkiak nuk i ka miratuar dorëheqjen", u shpreh zv.kryetari i KQZ-së, Denar Biba.

DEBATI

Kryetari i Partisë Konservatore, njëherësh kandidat në pritje për të marrë mandatin e deputetit, Kujtim Gjuzi u përfshi dje në një debat të fortë me sekretarin e përgjithshëm të KQZ-së, Ylli Merakaj. Gjuzi është anuar



Kandidat në pritje për të marrë mandatin e deputetit, Kujtim Gjuzi

KËRKESA

"E para, unë s'nxitoj për të marrë diçka z.sekretar i përgjithshëm i KQZ. Nëse vartësit tuaj më thonë na prisni në holl, unë këtë s'mund ta pranoj, se jemi në zyrat e shtetit shqiptar. Kryetari e bëri këshillimin e tij dhe unë e falënderoj për këtë. Do vij ditë për ditë në KQZ, nëse ka shqetësime për ato që ju thon për vonesat në listat e kandidatëve. Ju prisni që për 140 deputetët që do të shkojnë në Parlament ta çoni deri në fund të vitit, por ne s'mund të presim këstu", tha z.Gjuzi.

2 prilli, Vokshi: Turp ti kërkosh Ruçit një minutë heshtje

Rudina Hajdari, kritikëve: PD ka 28 vite që bën politikë me Ruçin

Deputetja Rudina Hajdari i kundërpërgjigj dje kritikave nga ish-deputetët demokratë se kërkoi një minutë heshtje në parlament nga Gramoz Ruçi për 4 dëshmorët e 2 prillit. Në një përgjigje për sulmet, deputetja demokratike shprehet se nuk ishte fyerje ajo që bëri në parlament, por një akt dinjtoz. Deputetja akuzoi PD-në se ka bërë politikë për 28 vite me Gramoz Ruçin, ndërkohë që pranoi në grupin e saj parlamentar Kastriot Islami dhe Luftër Xhuvelin. "Të kërkosh nderim zyrtar me heshtje në Kuvend për martirët e demokracisë nuk është fyerje, por akt dinjtoz për



ata që besojnë në vlerat demokratike. Ata që bëjnë sikur e duan shumë të djathtën, duhet të kenë parasysh se me Gramoz Ruçin dhe partinë e tij kanë 28 vite që bëjnë politikë. Të mos harrojnë historinë, se z. Islami që ishte kryetar i Kuvendit komunist e kanë bërë pjesë të grupit parlamentar, ndërsa me Luftër Xhuvelin kanë


mbajtur koalicion. Drejtësi duhet të bëhet për martirët e demokracisë, ashtu siç edhe për dhjetëra raste të rënda në Shqipëri, të cilat kanë mbetur si gjurma në akull si shkak i politikës 28-vjeçare", thekson Hajdari. Pas kërkesës se saj për të mbajtur një minutë heshtje në nderim të 4 viktimave të 2 prill, reagoi ish-deputetja e PD-së, Albana Vokshi. Ajo postoi në "Facebook" një dokument të firmosur nga Gramoz Ruçi, ministër i Brendshëm në atë kohë, duke theksuar se është turp të kërkosh një minutë heshtje për 4 dëshmorët e demokracisë nga ata që urdhëruan vrasjen e tyre!

hen. Nuk po i hyj se kush ka qenë rasti konkret", deklaroi z.Zguri. Por, Ilir Merakaj tha: "Unë e shoh çdo ditë zotërinë (Kujtim Gjuzin) nëpër korridoret e KQZ-së. Tani kemi edhe punë të tjera, s'mund ta presim çdo sekondë dhe t'i japim...". Kurse Kujtim Gjuzi

se ekspertët e KQZ-së e lënë të presë në hollin e KQZ-së, ndërkohë që është shprehur se kërkon të marrë mandatin e deputetit dhe s'mund të presë procedurat që po zvarriten. Por, kreu i KQZ-së këshilloi sekretarin e KQZ-së t'i presë të gjithë person-

at, por në një "shpërthim" të momentit, Ylli Merakaj ka thënë se Kujtim Gjuzi rri çdo ditë në korridoret e KQZ-së dhe se s'mund të merret me të çdo ditë, pasi ka dhe punë të tjera. "Ne jemi zyrtarë të shtetit, takimet të zhvillohen sa herë që ato do kërk-

ohen. Nuk po i hyj se kush ka qenë rasti konkret", deklaroi z.Zguri. Por, Ilir Merakaj tha: "Unë e shoh çdo ditë zotërinë (Kujtim Gjuzin) nëpër korridoret e KQZ-së. Tani kemi edhe punë të tjera, s'mund ta presim çdo sekondë dhe t'i japim...". Kurse Kujtim Gjuzi



Një nga protestat e opozitës

Protesta, sulmi mbi banorët tek "Unaza e Re"

Protesta në Unazën e Re u shoqërua mbrëmë me një konflikt midis banorëve dhe Policisë së Shtetit, që ka provokuar banorët. Ndërkohë një makinë që drejtohej nga një shtetas i paidentifikuar është futur dy herë mes turmës, ku kishte gra dhe fëmijë, ndërkohë që nga tmerri janë dëgjuar ulërimat e fëmijëve të traumatizuar. Protestuesit i kanë bërë thirrje policisë që të qëndrojë larg tyre dhe të mos provokojë. Nuk dihet se kush e drejtoi makinën, por sipas PD-së, policia nuk ka ndërhyrë për të ndaluar shoferin që rrezikoi jetën e banorëve.



Kryemadhi: Qeveria, asnje subvencionim për blegtorët e Radomirës

Drejtesia e LSI, Monika Kryemadhi, zhvilloi dje një takim në Radomirë të Kalasë së Dodës, ku është zhvilluar me blegtorët të kësaj zone. Në një postim në "Facebook", Kryemadhi akuzon qeverinë se nuk ka dhënë asnjë subvencionim për blegtorët e kësaj zone. Pas protestës së opozitës para Kuvendit, Kryemadhi shprehet se ka qenë sot në Kalanë e Dodës, ku takoi nga afër blegtorët e fermerët. Ata ndarë bashkë kafën e mëngjesit, ndërsa Kryemadhi dëgjoi hallet e problemet e tyre. Fermerët janë shprehur se nuk ka asnjë subvencionim për blegtorët në këtë zonë. "Sot (dje) kafën e mëngjesit në Radomirë të Kalasë së Dodës, me njerëzit fisnikë të kësaj zone. Asnjë subvencionim për blegtorët në këtë zonë. Numri i bagëtive ka pësuar një ulje drastike, ashtu si edhe fondi i subvencionimeve për bujqësinë në buxhetin e shtetit, që është ulur me rreth shtatë here", shprehet kryetaria e LSI-së.

u shpreh: "E para, unë s'nxitoj për të marrë diçka zoti sekretar i përgjithshëm i KQZ. Nëse vartësit tuaj më thonë na prisni në holl, unë këtë s'mund ta pranoj, se jemi në zyrat e shtetit shqiptar. Kryetari e bëri këshillimin e tij dhe unë e falënderoj këtë.

Unë do vij ditë për ditë në KQZ, nëse ka shqetësime për ato që ju thon për vonesat në listat e kandidatëve. Ju prisni që 140 deputetët që do shkojnë në parlament, ju doni ta çoni deri në fund të vitit, por ne s'mund të presim këstu".



Valentina Madani

Lideri i opozitës shqiptare Lulzim Basha informoi parlamentarët gjermanë gjatë takimeve në Berlin se në Shqipëri qeveria socialiste qeveris me kriminelët dhe se në Europë nuk shkohet me gënjeshtër, hilerë dhe shtet të kapur nga krimi. Sipas tij në Europë shkohet me vlera kushtetuese ndërsa foli për dosjen 339, e cila dokumenton edhe vjedhjen e votës në parlament. Lulzim Basha, nga Berlini ku ndodhet në një vizitë për takime me parlamentarë gjermanë, foli rreth situatës politike në Shqipëri. Basha bëri të ditur se ka zhvilluar takime në Bundestag dhe me qeverinë federale gjermane. Ai nënvizon se në Europë nuk shkohet me gënjeshtër dhe me shtet të kapur nga krimi.

ZGJEDHJET

Sipas kreut të PD-së, pa ndëshkimin e atyre që vodhën votën në 2017 dhe largimin e Edi Ramës nuk do të ketë zgjedhje lokale. "Çështja e zgjedhjeve lokale zgjidhet vetëm pasi të ndëshkohen ata që janë kapur duke vjedhur zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale të kaluara. Pa undëshkruar, pa marrë fund ky model i bashkëpunimit të kimit të organizuar dhe qeverisjes nuk bëhet fjalë për normalitet apo zgjedhje të tjera. Emergjencë kombëtare është rikthimi i besimit të shqiptarëve tek procesi zgjedhor. Përveç largimit të qeverisë aktuale dhe një qeverie tranzitore të çohen para drejtësisë dosja 339 dhe kokat politike të përfshira në këtë dosje", deklaroi z.Basha. I pyetur nga DW nëse opozita do të kthehet në parlament, Basha tha se "nuk ka kthim pas". "Largimi nga parlamenti ndodhi pas çdo shterimi të çdo mundësie për të zgjidhur në mënyrë institucionale këtë krizë të thellë legjitimiteti. Ju kujtoj se partnerët gjermanë në Bundestag, në qeverinë gjermane i njohin këto probleme, ikemi ngjitur këto shqetësime prej kohësh, që para një viti. Për fat të keq gjërat këtë vit nuk janë përmirësuar, por janë përqesuar. Jo vetëm kaq, por tani më kemi prova zyrtare të bashkëpunimit të qeverisë me krimin e organizuar. Dalja e opozitës është pa kthim, kriza politike është reale, por kështu është një oportunitet, një mundësi e madhe, jo thjeshtë për të larguar një qeverisje të lidhur me krimin, por për t'i dhënë shqiptarëve një sistem demokratik, funksional, që u shërben atyre dhe jo partive apo thjeshtë e vetëm klasës politike. Kam besim të madh se ky transformim, që tashmë ka nisur, me opozitën në krah të qytetarëve dhe jo në krah të kriminelëve apo personave të emëruar nga krimi në parlament do të ketë mbështetje nga të gjithë shqiptarët e ndërsëhm. Dhe jam shumë i inkurajuar se edhe këtu në Bundestag dhe në institucionet gjermane, kemi gjetur mbështetje për këtë ax-

"Ofertë për Bushatin? Për Shqipërinë europiane, bashkëpunojmë me të gjithë"

Lulzim Basha: Për zëvendësimin e qeverisë kemi mbështetjen gjermane

"Dalja nga parlamenti, një rrugë pa kthim"



Kreu i opozitës, Lulzim Basha

DEKLARATA

"Unë jam me shumë shpresë, ka njëzërë që janë të trembur nga ky ndryshim, janë ata që fatin politik e kanë lidhur me krimin, jo me qytetarët. Por unë e di që edhe në gjirin e PS pjesa më e madhe nuk janë ata që kanë përfituar nga bashkëpunimi me krimin", deklaroi z.Basha.

qëria civile, intelektualët dhe media e lirë. Hapi i parë i domosdoshëm është çuarja para drejtësisë e të gjithë politikanëve socialistë të kapur nga prokuroria zyrtarisht, në bashkëpunim me krimin e organizuar duke shkatërruar procesin zgjedhor të vitit 2017-të. Këto janë vetëm hapat e parë, por ne duhet që për këtë transformim të madh i cili duhet të futet edhe në çështje të tilla si sistemi zgjedhor. Mundësia e forcimit të rolit të parlamentit, garancitë që drejtësia të jetë e pavarur dhe do të çojë deri në fund çështjet e korrupsionit të lartë zyrtar. Liria e medias, mundësia e qytetarëve për t'u shprehur përmes referendumit", deklaroi z.Basha.

OFERTA

Nga Berlini kreu i PD, Lulzim Basha deklaroi që edhe në PS ka shumë persona që nuk kanë përfituar nga bashkëpunimi me krimin. Në një intervistë për DW, ai kërkoi nga socialistët e ndërsëhm të bashkohen tek vlerat evropiane. "Unë jam me shumë shpresë, ka njëzërë që janë të trembur nga ky ndryshim, janë ata që fatin politik e kanë lidhur me krimin jo me qytetarët. Po unë e di që edhe në gjirin e PS pjesa më e madhe nuk janë ata që kanë përfituar nga bashkëpunimi me krimin. Ne mund të kemi pikëpamje të ndryshme për zhvillimin e Shqipërisë, ne mund të kemi pikëpamje të ndryshme për sektorë të rëndësishëm të jetës, por ne duhet të bashkohemi tek vlerat evropiane të zgjedhjeve të lira dhe të ndërsëhm, një parlament të dalë nga vota e qytetarëve, një qeveritë që i përgjigjet parlamentit dhe qytetarëve, një drejtësi të pavarur që nuk i mbron, por i ndëshkon politikanët e korruptuar", deklaroi z.Basha. Pyetjes së drejtpërdrejtë të DW nëse është kjo një ofertë për Bushatin, kreu i PD-së iu përgjigj: "Ka shumë zëra publik dhe jo publik që konfirmojnë se problemi i kaptjes së shtetit nga krimi i organizuar, është po kaq problem kombëtar sa ç'është një problem për PS. Unë uroj që PS të gjejë forcën, t'i shërbejë këtij transformimi kombëtar për të ndërtuar së bashku vlerat evropiane në Shqipëri, duke filluar me zgjedhje të lira dhe të ndërsëhm, duke filluar me ndëshkimin e politikanëve të kapur duke vjedhur zgjedhjet e kaluara. Me jemi gatë të bashkëpunojmë me ata që duan një të ardhme evropiane për Shqipërinë".

hendë transformuese dhe që shkon përtej thjesht zëvendësimit të kësaj qeverie me një qeveri tjetër. Shkon përtej thjesht organizimit të zgjedhjeve të ndërsëhm e të lira për një herë, ne duam një reformë të thellë, një transformim të thellë të demokracisë shqiptare. Ne duam vlerat e vërteta evropiane. Të garantojmë që pushtet të jetë të pavarur nga njëri-tjetri, të garantojmë se parlamenti i ardhshëm të jetë me të vërtetë

parlament, dhe jo thjesht një noter i kryeministrit. Të garantojmë që reforma në drejtësi të prodhojë rezultate, të prodhojë ndjekje të sukseshme penale", theksoi z.Basha.

QEVERISJA

Z.Basha vlerësoi se opozita e vendit nuk do të ndalet së kërkuari si qëllim final vendosjen e një sistemi demokratik funksional në shërbim të qytetarëve shqiptarë. Basha tha se për këtë

synim, opozita shqiptare ka mbështetjen gjermane. "Është emergjencë kombëtare, jo thjeshtë dhe vetëm të largojmë një qeveri të kapur duke vjedhur zgjedhjet, dhe pastaj duke vjedhur shqiptarët, po të ndërtojmë të gjithë së bashku një proces transformues, një ndryshim të madh, ku padyshim rol duhet të kenë të gjithë, edhe socialistët e ndërsëhm, opozita që natyrisht është në ballë të kësaj përpjekje, edhe sho-

NEGOCIATAT

Tsipras e Rama bisedë telefonike, diskutojnë për pranimin e Shqipërisë në BE

Kryeministri i Greqisë, Aleksis Tsipras zhvilloi dje një bisedë telefonike me kryeministrin e Shqipërisë Edi Rama. Mediat greke raportojnë se gjatë bisedës, dy kryeministrit diskutuan reformat e nevojshme për të filluar procesin e pranimit të Shqipërisë në BE. Sipas burimeve diplomatike, kryeministri Tsipras, në me homologun e tij shqiptar, u përqendrua në ligjin mbi pronën në bregun e Jonit dhe në Aktin e Minoriteteve. Ata diskutuan gjithashtu zhvillimet rajonale dhe marrëdhëniet ekonomike dypalëshe. Por telefonata e kryeministrit Edi Rama me homologun grek Aleksis Tsipras, vjen menjëherë pas jehonës për vendimin e marrë për pronat në Himarë nga shtypi grek. Pak ditë më parë Aleksis Tsipras dërgoi një mesazh të qartë Shqipërisë nga Samiti i Rumanisë, ku ndodhjet, pas publikimit të vendimit ministror për pronat e himarjotëve në Fletoren Zyrtare. Zyra e shtypit të kryeministrit grek thekson se axhenda e bisedës telefonike përfshinte reformat e Shqipërisë për integrimin në BE. Burime theksojnë se Tsipras u ndal gjatë në çështjen e pronave në detin Jon si dhe në legjislaturë përkatëse për minoritarët. Gjithashtu, u diskutuan marrëdhëniet bilaterale ekonomike dhe zhvillimet e fundit në rajonin ballkanik.

Përgjimet, Salianji: Kreu i policisë Fier duhet të burgoset

Ish-deputeti i PD-së, Ervin Salianji, kërkoi dje arrestimin e drejtorit të ri të Policisë së Fierit, Andon Markos. Sipas Salianjit, ai duhet të burgoset për dëshmi të rreme. "PD u ka shpjeguar shqiptarëve se në këtë skemë të rëndë manipulimi shtetëror, një rol kyç ka prokuroria e kapur prej Edi Ramës dhe rasti i Andon Markos e provon sërish këtë. Nga përgjimet fakteohet se drejtori i ri i Policisë së Fierit jo vetëm ka dënuar për skemën e blerjes së dëshmitarit të rremë të qeverisë, por se ai e ka takuar disa herë atë. Kjo e bën shefin e ri të policisë së Fierit një mashtues, që duhet arrestuar menjëherë për dëshmi të rreme", tha z.Salianji. Ai përmendi se: "Në datën 17 tetor, Andon Marko ka deklaruar në prokurori se me Fredi Alizotin, dëshmitarim e rremë, është takuar vetëm 1 herë, pasi i është kërkuar në 1 qershor nga drejtori Albert Nushi".



Bylykbashi: Cila forcë opozitare fiton ndaj shtetit të kapur?

Ish-deputeti demokrat Oerd Bylykbashi akuzon max horancën se sabotoi dy herë reformën zgjedhore në tetor dhe dhjetor të vitit të kaluar. Pas thirrjeve të fundit nga maxhoranca për opozitën për të kontribuar për reformën zgjedhore, Bylykbashi tha në studion e "News 24" se maxhoranca i hoqi shanset për një marrëveshje. "Është goxha e vonuar në këtë vullnet të rilindur për reformën zgjedhore. Kishte mundësinë të mos e sabotonte siç bëri në tetor dhe në dhjetor. Ne po punojmë drejt një konkluzioni teknik, dy herë solli drafte të njëanshme duke shkatërruar vullnetin politik. Hoqi shanset për një marrëveshje", theksoi ai. Bylykbashi kujtoi edhe darkën e famshme të "Krokodil" dhe ofertën e ish-kryeministrit Berisha për Edi Ramën, atëherë kreu i opozitës. Ai e quajti retorikë bajate qëndrimin e maxhorancës sot karshi opozitës. "Është retorikë bajate. Kur Sali Berisha i ofronte këtë në 2010 Edi Ramës dhe ai nuk e pranonte, kur i thoshte në darkën e famshme të krokodilit që bëj gjithçka sipas rekomandimeve të OSBE-ODIHR, ai nuk e pranonte. Në fund ashtu u bë, por zgjati. Ishte një ofertë bujare dhe e vërtetë. Bënë propozime i mbështetëm, i miratuar së bashku", tha Bylykbashi. Nuk munguan akuzat e tij për maxhorancën për çështjen e drejtësisë, dosjen 184 dhe politizimin e administratës. "Shteti është i kapur nga PS që është sot në pushtet. Cila është ajo forcë opozitare që konkurron dhe fiton ndaj shtetit të kapur?", tha Bylykbashi.

KUVENDI MANDATET

Parlamenti ka publikuar pagat dhe të ardhurat e tjera për 2 muajt e parë të 2019-ës

Dogjën mandatet, Kuvendi u mban ish-deputetëve pagën e shkurtit

Përfaqësuesit e opozitës janë paguar për 3 javë

Përveç mandatit si të zgjedhur të popullit në Kuvend, ish-deputetët e opozitës kanë humbur edhe të ardhurat dhe të gjitha privilegjet e tjera që burojnë nga statusi i deputetit. Kuvendi i Shqipërisë është treguar kategorik dhe ka vendosur që të respektojë ligjin me përpikmëri sa i përket trajtimit financiar të përfaqësuesve të opozitës. Kështu, ky institucion ka publikuar të dhënat për pagat dhe të ardhurat e tjera që kanë përfituar deputetët gjatë muajve janar dhe shkurt, që janë edhe dy muajt e fundit kur opozita ishte e pranishme në Kuvend. Por, ajo që vihet në tabelën e pagave dhe të ardhurave të tjera për muajin shkurt është fakti që Kuvendi i ka paguar deputetët vetëm për pjesën që ishin pjesë e këtij institucioni. Ndërkohë që ka bërë ndalesën e pagës, ditëve dhe honorareve të tjera për pjesën e ditëve që ata zyrërisht kanë qenë deputetë dhe u mandatave dhe u larguan nga Kuvendi. Më konkretisht sa i përket pagës, Kuvendi i ka njohur si pagesën bruto vetëm 1.1 milionë lekë të vjetra nga 1.56 milionë lekë të vjetra që është paga bruto e një deputeti. Pra, siç shihet nga tabela e publikuar, Kuvendi i ka paguar ish-deputetët e opozitës për 21 ditët e shkurtit që ata kishin mandatin, ndërkohë që i ka mbajtur pagesën për javën e 4 të shkurtit. Kujtojmë se opozita zyrërisht aktin e dorëzimit të mandateve të deputetëve në datë 21 shkurt, kur kryedemokrati Lulzim Basha së bashku me disa deputetë të tjerë dorëzuan dosjen me të gjitha dorëheqjet në protokollin e Kuvendit. Ndërkohë që paga neto për deputetët e opozitës ka shkuar në vetëm 820 mijë lekë të vjetra, pasi atyre i janë mbajtur kontributet shoqërore dhe ato shëndetësore, si dhe taksat. Natyrisht që në listën e ish-deputetëve të opozitës ka edhe nga ata që kanë marrë edhe më pak se sa kjo shumë, kjo pasi ata kanë bërë edhe mungesa të tjera gjatë 3 javëve të shkurtit. Nga ana tjetër, e njëjta gjë ka ndodhur edhe me të ardhurat e tjera që merr një deputet për shkak të statusit të deputetit. Bëhet fjalë për të ardhurat si honorarë, dieta, pagesë karburanti, telefoni apo qira shtëpie apo pagesë hoteli. Administrata e Kuvendit ka bërë ndalesat



Ish-deputetët e opozitës duke dalë nga Kryesia

DIETAT

Sipas vendimit të Kuvendit, një deputet paguhet 170 mijë lekë të vjetra si pagesë për telefonin, ndërkohë që të zgjedhurit e opozitës kanë marrë shumën që variojnë nga 120 deri në 130 mijë lekë. Ndërkohë që ajo që bën diferencën e madhe të këtë grup të ardhurash janë dietat. Ndërsa socialistët janë paguar në shkurt për dietat me afro 720 mijë lekë, ish-deputetët e opozitës nuk kanë marrë asnjë lek.

Berisha dhe Basha më pak të paguarit, ish-ministrat paguheshin si deputetë

Ish-kryeministri Sali Berisha dhe kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, rezultojnë të jenë ish-deputetët më pak të paguar gjatë muajit shkurt. Nga tabela e pagave dhe të ardhurave të tjera, rezultojnë se Berisha dhe Basha kanë përfituar më pak lekë. Kështu, ata kanë përfituar vetëm 370 mijë lekë të vjetra si pagesë për karburantin dhe telefonin, dhe asnjë lek për dietën, ndonëse për tri javët e para të shkurtit ata ishin ende deputetë. Ndërkohë që një element tjetër që vihet në listën e pagesave për këto dy muajt është edhe futja në të e të gjithë ish-ministrave socialistë që u larguan nga Rama në mes të janarit. Siç shihet në listën e pagesave dhe të



ardhurave të tjera, 7 ish-ministrat socialistë, si Lindita Nikolla, Senida Mesi, Mirela Kumburo, Ditmir Bushati, Damian Gjinkuri, Niko Peleshi dhe Arben Ahmetaj kanë filluar gjatë muajit janar të paguheshin si deputetë, pasi më parë pagu-

heshin në ministratë ku drejtonin. Gjatë muajit janar ata janë paguar për gjysmën e muajit, që nga momenti i largimit të tyre nga qeveria. Më konkretisht, për këtë muajt janë paguar 780 mijë lekë bruto dhe 590 mijë lekë neto.

ti, telefoni, dietat dhe qiratë. Ndërsa një deputet i mazhorancës ka arritur të marrë rreth 1.6 milionë lekë nga këto të ardhura, shumën që kanë marrë përfaqësuesit e opozitës variojnë nga 370 mijë lekë të vjetra në 820 mijë lekë të vjetra.



Gjatë një seance parlamentare

PAGAT

Emri	Paga Neto	Emri	Paga Neto
Emer Mbiemer	61,001	Elena	115,615
Agron Cela	61,001	Endri Hasa	71,511
Adelina Rista	115,615	Endrit Brahimllari	82,021
Albana Vokshi	86,537	Enkelejd Alibeaj	71,511
Aldo Burci	82,021	Ervin Salianji	82,021
Anastas Angjeli	115,615	Facil Nasufi	115,615
Andrea Marto	115,615	Fatbardha Kadu	76,766
Antoneta Dhima	115,615	Fatmir Velaj	115,615
Andul Xhindi	115,615	Flamur Golemi	115,615
Bashkim Fino	115,615	Florida Kërpaçi	82,021
Besnik Baraj	115,615	Gjetan Gjetani	99,850
Blerina Gjylameti	115,615	Gida Shqina	82,021
Bujar Çela	115,615	Halim Kosova	82,021
Dashamir Shehi	76,766	Hekuran Hoxhalli	66,256
Edi Paloka	87,488	Ilir Beqaj	115,615
Edmond Spaho	89,686	Ilir Ndraxhi	115,615
Ervin Bushati	115,615	Ismet Begiraj	115,615
Evis Kushi	115,615	Isuf ?elaj	82,021
Fatmir Mediu	81,031	Izmiria Ulliqnaku	66,256
Fidel Ylli	110,360	Jurgis 7yrbja	110,360
Flamur Noka	82,021	Klevis Balliu	66,256
Florion Mima	66,256	Klotilda Bushaja	115,615
Genc Pollo	86,537	Lindita Metallah	82,021
Gent Strazimiri	71,511	Lorenc Luka	66,256
Gramoz Ruçi	166,203	Luan Harusha	115,615
Ilir Xhakolli	115,615	Luan Baçi	82,021
Ilirjan Pendavini	115,615	Lulezim Basha	82,021
Jorida Tabaku	76,766	Myslim Murrizi	115,615
Klodiana Spahiu	115,615	Nadire Mëgorapaj	76,766
Kejdi Mehmetaj	82,021	Nasip Naço	76,766
Luan Rama	76,766	Nora Malaj	76,766
Luan Duzha	115,615	Nuri Belba	115,615
Luciano Boci	82,021	Orjola Pampuri	82,021
Monika Kryemadhi	82,021	Reme Lala	110,360
Musa Ullqini	115,615	Roland Xhelilaj	115,615
Nard Ndoka	105,105	Romeo Gurakuqi	66,256
Oerd Blylykbashi	66,256	Rrahman Rraja	115,615
Paulin Sterkaj	115,615	Rudina Hajdari	115,615
Perparim Spahiu	76,766	Sadi Vropsi	115,615
Pjerin Ndreu	115,615	Sezai Rokaj	82,021
Rakip Suli	115,615	Tatiana Piro Nurçe	115,615
Robert Bitri	115,615	Tritan Shehu	82,021
Sadri Abazi	110,360	Valentina Duka	82,021
Sali Berisha	82,021	Viktor Tushaj	76,766
Taulant Balla	132,147	Vilma Bello	115,615
Tom Doshi	105,105	Vlunet Sinaj	115,615
Ulsi Manja	121,127	Xhemal Gjunkshi	82,021
Vangjel Dule	76,766	Eglantina Gjermeni	115,615
Vangjel Tavio	61,001	Klajda Gjonaj	82,021
Vasilika Hysi	137,296	Milva Ikonishi	115,615
Xhemal Qefalia	115,615	Mimi Kodheli	121,127
Edmond Leka	115,615	Emonela Felaj	121,127
Dhurata Çupi	71,511	Lefter Koka	84,085
Xhevit Bushaj	115,615	Edmond Panariti	82,021
Petrit Vasili	95,693	Dritan Bici	115,615
Adnor Shameti	115,615	Silva Caka	#REF!
Agron Shehaj	71,511	Astrit Velaj	#REF!
Alket Hyseni	115,615	Spartak Braho	115,615
Almira Xhembulli	115,615	Fatmir Xhafa	115,615
Andon Frokaj	82,021	Senida Mesi	118,215
Arben Pellumbi	115,615	Lindita Nikolla	118,215
Arben Kamami	115,615	Mirela Kumburo	118,215
Bardh Spahia	76,766	Niko Peleshi	123,727
Elena Xhina	115,615	Arben Ahmetaj	123,727
Edlira Boda	115,615	Damian Gjinkuri	118,215
Edmond Haxhinasto	76,766	Ditmir Bushati	118,215



Qeveria miratoi dje vendimin për krijimin e "Illyrian Guard" me kapital shtetëror

Krijohet "security" shtetërore, do të punësohen policët para pensionit

Shoqëria e sigurisë, në varësi të Ministrisë së Brendshme

Një javë më parë nga foltorja e Kuvendit, kryeministri Edi Rama u tregua kritik ndaj ministrit të Brendshëm për vonesat e sjelljes për miratim të një vendim të posaçëm për krijimin e një kompanie të sigurisë së Policisë së Shtetit, e cila do të shërbente për sigurinë fizike dhe asaj të objekteve. Sipas Ramës, kjo lloj kompanie do të shërbente edhe si një "strehë" për të gjithë ata policët të moshuar apo që nuk përbushnin parametrat fizikë për të shërbyer më në radhët e Policisë së Shtetit. Ndërkohë që nuk kaloi as një javë dhe qeveria miratoi dje një vendim të posaçëm për krijimin e "Illyrian Guard", një shoqëri e mirëfilltë e policie, që ofron shërbime për personat fizikë e juridikë publikë dhe privatë. Bëhet fjalë për krijimin e një shoqërie tregtare me kapital 100% (njëqind) shtetëror. Shoqëria "Illyrian Guard", sh.a., do të themelohet, organizohet dhe do të funksionojë si shoqëri aksionare, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Kapitali fillestar për krijimin e shoqërisë "Illyrian Guard", sh.a., është përcaktuar të jetë 10 000 000 lekë të reja dhe autoriteti publik që përfaqëson shtetin si pronar të 100% të aksioneve të shoqërisë "Illyrian Guard", sh.a., është Ministria e Brendshme. Shoqëria "Illyrian Guard", sh.a. do të ofrojë shërbime me pagesë, kundrejt subjekteve të treta, publike apo private, në fushën e rendit e të sigurisë publike, teknologjisë së informacionit, si dhe çdo shërbim tjetër në përputhje me qëllimin e krijimit dhe statutin e saj. Gjithashtu, ajo do të ofrojë shërbime mbështetëse në Ministrinë e Brendshme dhe institucionet në varësi të saj, në zbatim të kompetencave që i njihen kësaj të fundit sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore. Ndërkohë që mënyra e përllogaritjes së tarifave të shërbimeve specifike, që do u ofrohen subjekteve publike do të përcaktohet me udhëzim të përbashkët të ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi, për krijimin e kapitalit fillestar të shoqërisë, në vlerën 10 000 000



Foto ilustruese

SHËRBIIMI

Të gjitha institucionet dhe subjektet publike, të cilat kanë në administrim objekte shtetërore, ruajtja dhe siguri i të cilave duhet të realizohet nga shërbime të specializuara për këtë qëllim, duhet t'i drejtohen me kërkesë kësaj shoqërie për të përfituar shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike.



Braçe: Qeveria legjitime, asnjë komisioner nuk e kontestoi rezultatin

Zëvendëskryeministri Erjon Braçe ishte dje Vlorë dhe në Patos për të monitoruar nga afër zbatimin e orarit të punës në disa institucione shtetërore, siç është porti, doganat etj. Gjatë këtyre vizitave të paparalajmëruar, ai konstatoi disa shkelje të disa prej drejtuesve të këtyre institucioneve për vonesa në ardhjen e në punë dhe largime nga vendi i punës gjatë orarit zyrtar. Ndërkohë, ai nuk iu shmang edhe interesit të mediaeve për të folur mbi zhvillimet politike, duke theksuar edhe një herë se mazhoranca dhe qeveria që e përfaqëson atë është legjitime. "Ne jemi legjitimë në Kuvendin e Shqipërisë. Unë nuk di të kemi marrë pushtet legjitim. Mënyra si kanë votuar qytetarët është certifikuar nga ndërkombëtarët që e konsideron qeverinë dhe parlamentin legjitim. Është e tepërt që të komentoj palën tjetër, që është opozita e vjetër, e vjetër edhe si histori, edhe për shkak të personazheve që e kryesojnë", - tha Braçe. I pyetur për deklaratat e deputetit socialist, Ditmir Bushati, numri dy i qeverisë theksoi se qeveria dhe mazhoranca e majtë ka siguruar të drejtën e protestës për këdo. "Ju kujtova çfarë ka ndodhur në 1993, ndërkohë që lideri i opozitës ishte në burg, sot është në Bruksel, Berlin, sorollatet lart e poshtë dhe njerëzit i lë aty në mes të katër rrugëve. Nga Shkodra në Sarandë nuk ka një votë të kontestuar nga një komisioner i PD-së, që legjitimon qeverinë socialiste. Është i dobishëm dialogu, por më e dobishme ligjshmëria, nuk i jam i gatshëm për të folur për zgjidhje ekstraligjore dhe Kushtetuese, që i vijnë ndesh ligjit", - tha Braçe.

Deputeti Xhafaj: Oficerët e Policisë Gjyqësore janë sekserë të prokurorëve

Deputeti socialist, Fatmir Xhafaj, nuk i ka kursyer dje kritikën rreth veprimtarisë që kryejnë oficerët e Policisë Gjyqësore. Ai lëshoi akuza të forta dje në Komisionin e Ligjeve, duke theksuar oficerët e Policisë Gjyqësore janë kthyer në sekserë të prokurorëve. Nga ana tjetër, ai theksoi se edhe kompetencat, edhe varësia e oficerëve të policisë gjyqësore nuk janë të qarta. "Oficerët e policisë gjyqësore në sanksionet pranë prokurorëve në shumicën e rasteve shërbejnë si sekserë të prokurorëve. Nga mënyra se si është organizuar, kanë shërbyer për të zgjidhur çështje të raportit mes prokurorëve dhe klientëve, me shumë sesa për hetime profesionale", - tha Fatmir Xhafaj gjatë diskutimit të nisjes



Xhafaj

"Oficerët e policisë gjyqësore në sanksionet pranë prokurorëve në shumicën e rasteve shërbejnë si sekserë të prokurorëve. Nga mënyra se si është organizuar, kanë shërbyer për të zgjidhur çështje të raportit mes prokurorëve dhe klientëve, me shumë sesa për hetime profesionale"

për rolin e oficerëve të policisë gjyqësore. Vetëm një javë më parë, ai shprehu kritika edhe për ndryshimet në ligjin për vetingun e policëve, duke theksuar se ndryshimet e

paraqitura nga pasardhësi i tij në drejtimin e Ministrisë së Brendshme e bënin procesin e kontrollit të figurës së policit jo-demokratik.

lekë do të përballohen nga fondit rezervë i buxhetit të shtetit. Ministria e Brendshme do të transferojë këtë shumë pranë kësaj shoqërie menjëherë pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Të gjitha institucionet dhe subjektet publike, të cilat kanë në administrim objekte shtetërore, ruajtja dhe siguri i të cilave duhet të realizohet nga shërbime të specializuara për këtë qëllim duhet t'i drejtohen me kërkesë kësaj shoqërie, për të përfituar shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fiz-

ike. Vetëm nëse kjo shoqëri merr vendim për pamundësinë e ofrimit të shërbimit të kërkuar, institucionet dhe subjektet publike mund ta sigurojnë këtë shërbim në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi. Për veprimtarinë e shoqërisë "Illyrian Guard", sh.a. Ministria e Brendshme i siguron nga inventari i saj i pronave publike, mjediset e punës të nevojshme për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë. Gjatë fjalës së tij në Kuvend, kryeministri Rama tha se policia e sotme private është

të jashtë çdo lloj standardi ndaj krijimit të kësaj shoqërie të Policisë së Shtetit do të ofrojë profesionalizëm, ndërsa do të jetë një mundësi e mirë edhe për punësimin e atyre policëve që janë në prag pensioni. "Do t'u krijohet mundësi shumë prej punonjësve, që tanimë janë në një moshë të caktuar dhe nuk kanë më mundësi të na japin atë efikasitet që kërkohet, që të bëjnë një kalim të butë nga dalja nga shërbimi në Policinë e Shtetit, në daljen në pension", - tha Rama.

Lihen në qeli edhe 5 qytetarë që morën pjesë në protestë

Tubimi i 16 shkurtit i opozitës, Apeli lë në burg ish-kreun e Policisë Bashkiake, Florenc Hoxhën

TIRANË - Gjykata e Apelit në Tiranë ka vendosur dje masën e sigurisë për protestuesit e opozitës, të cilët u shoqëruan më 16 shkurt. Kjo gjykatë ka lënë në burg Florenc Hoxhën (ish-kreu i Policisë Bashkiake, Tiranë, gjatë mandatit të Lulzim Bashës), i cili u shoqërua në polici mbremjen e 16 shkurtit, pasi policia ka ushtruar kontroll në banesën e tij. Hoxha është fotografuar nga shërbimet e policisë në protestë. Gjatë seancës së djeshme, Hoxha nëpërmjet avokatit të tij, Ivi Kaso, kërkoi për të dytën herë zëvendësimin e masës së sigurisë "arresti

KREU I FRPD

"Gjykata e Apelit në Tiranë vendosi një standard të paprecedentë duke lënë në burg një student, Mariglen Sh. Doçi, pa asnjë provë, pa asnjë fakt, por vetëm me urdhrin politik të Edi Ramës. Nëse Mariglen Doçi do të ishte trafikant droge, përdhunues në grup ose kriminel, ai me siguri sot do të ishte deputet, ose kryetar bashkie i PS-së", tha kreu i FRPD-së, Belind Këlliçi.

hepit dhe Agim Pepochit. Apeli refuzoi të pranonte ankimin e prokurorisë për të rikthyer në qeli 10 protestues, për të cilët më herët Shkalla e Parë kishte caktuar "detyrim paraqitje". Ndërsa, Pal Dijsa, Gazmir Bekshiu, Aldi Spaho, Ermir Bru-



Ish-kreu i Policisë Bashkiake, Florenc Hoxhën

ka dhe Emilajno Mustafa janë lënë në arrest shtëpie. Gjykata e Apelit vendosi masën "detyrim paraqitje" për shtetasit Klajdi Poci, Denaldo Buzi, Eduart Buzi, Florjan Zeneli, Jeton Saphiu, Ali Bruçi, Kenin Kastrati, Flamur Rraja, Edison Tahiri dhe Elidian Buzi. Familjarët së bashku me ish-deputetin e Partisë Demokratike,

Klevis Balliu kanë ankimuar masat. Balliu pohoi se nuk ka asnjë provë, por shtoi se Rama ka arrestuar qytetarët, pasi ka frikë dhe iu trembet protestave. Në një prononcim për mediat para gjykatës, kreu i FRPD-së e u shpreh se Gjykata e Apelit në Tiranë vendosi një standard të paprecedentë.

EMA GASHI: Më hoqën të drejtën që e njuh ligji. Debat edhe për vëzhguesin e ONM-së

Vetingu, KPA shtyn seancën, nuk pranon si "mbrojtëse" motrën e Rovena Gashit

Ish-prokurorja e Prokurorisë së Përgjithshme kërkon rrëzimin e vendimit dhe rikthimin në detyrë

TIRANË

Ish-prokurorja e Prokurorisë së Përgjithshme, Rovena Gashi, e njohur si krahu i djathtë i ish-kryeprokurorit Adriatik Llalla, pas shkarkimit nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka dalë dje para trupës së Kolegjit të Apelit, duke kërkuar rrëzimin e vendimit dhe rikthimin në detyrë. Seanca e parë u shty për shkak se KPA nuk pranoi që Rovena Gashi të kishte si ndihmëse ligjore motrën e saj, Ema Gashi. KPA e ka këshilluar Rovena Gashin të zgjedhë një avokat për mbrojtje, nëse e vlerëson të nevojshme dhe jo asistente. "Subjektet e rivlerësimit mund të zgjedhin avokat ose mbrojtës, por jo asistent apo ndihmës. Rovena Gashi ftohet të zgjedhë një avokat, nëse do", tha kryetarja e trupës, Albana Shtylla. Ndërsa motra e Rovena Gashit, Ema, akuzoi Kolegjin se e filloi procesin në shkelje. Ajo u shpreh se ligji i rivlerësimit të prokurorëve dhe gjyqtarëve, por edhe kodi i procedurës administrative e parashikon asistentin në proces. Ndërkohë që gjatë seancës pati replika edhe me përfaqësuesin ndërkombëtar të OMN-së. Vëzhguese dje ishte përcaktuar për të qenë Mia Rozing, por për sh-



Ish-prokurorja, Rovena Gashi

REAGIMI I EMA GASHIT

Pasi Komisioni i Posaçëm i Apelit i hoqi të drejtën të jetë përfaqësuese ligjore e motrës së saj Rovena Gashit, ka reaguar e motra, Ema Gashi. Sipas saj, Komisioni i Posaçëm i Apelit i ka hequr një të drejtë procedurale, që e njuh ligji. "KPA kufizoi të drejtën e subjektit për ndihmëse ligjor. Sipas ligjit, ndihmës i subjektit mund të jetë kushdo", - u shpreh ajo. Kolegji vlerësoi dje të mos legjitimojë Ema Gashin si ndihmëse ligjore të Rovena Gashit, të cilës iu këshillua një avokat. Pritet që seanca e radhës e ngjykitim të mbahet më 23 prill.

ka të probleme shëndetësore, në seancë ishte paraqitur Teo Jacobs, i njohur tashmë si i "i tmerrshmi" i gjyqtarëve dhe prokurorëve që kanë kaluar në veting. "Nuk jemi i njohur që do ishte ky vëzhguesi ndërkombëtar i ONM (Theo Xhacobs), që do merrte sot pjesë

në këtë seancë", - u shpreh në nisje të seancës, Ema Gashi. Por, tre anëtarët e KPA-së i kujtuan asaj se prit të ketë një vendim nëse do pranohet apo jo si ndihmëse e së motrës, Rovenës (subjekt i rivlerësimit). Seanca e radhës pritet të zhvillohet më 23 prill.



Ema Gashi

ISH-PROKURORJA ROVENA GASHI

Prokurorja e Prokurorisë së Përgjithshme, e cila në fakt është e pezulluar për shkak të një procesi penal është e para që hapi një betejë me Komisionin e Vetingut, ku në seancën dëgjimore e konsideroi vendimin e saj të parë gjykatës dhe të ndërmarrë muaj më parë, atëherë kur ish-in dërguar pyetjet e para nga Komisioni i Vetingut. Dhe tani që mori verdiktin e shkarkimit, Rovena Gashi ka kohë të merret me një çështje tjetër: të cilën e ka dërguar në Strasburg, ku kundërshtoi shtetin shqiptar për procedurat se si ajo u pezullua nga detyra. E njohur ndryshe si ish-krahu i djathtë i Adriatik Lallës, Rovena Gashi e ka filluar karrierën

në prokurori në vitin 2004. Ajo ka punuar si prokurorë në Tiranë nga viti 2004 deri në vitin 2013, kur u emërua në krye të Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme. Gashi e mbajti këtë detyrë deri në fund të dhjetorit 2017, kur kryeprokurorja e re, Arta Marku, e uli në detyrë. Ndërsa në maj 2018, prokuroria regjistroi procedimin penal ndaj saj dhe bashkëshortit Dritan Gina, të cilët po hetohen për pasurinë e tyre, ndërkohë që Marku i pezulloi të dy nga detyra. Gashi u bë pjesë e listës prioritare të vetingut përpara telasheve me pasurinë, për shkak të kandidimit të saj për Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe për Gjykatën e Lartë.

SHKURT

Sulmi ndaj policisë në Elbasan, Krimet e Rënda nisin procesin

TIRANË - Gjykata për Krime të Rënda hapi shqyrtimin gjyqësor të çështjes së përplasjes së makinës së policisë në Elbasan, në vitin 2017. Pas disa seancash të dështuara, dje prokuroria lexoi kërkesën për gjykim, ndërsa në seancën e radhës pritet të dëshmojnë 4 punonjës policie që kanë qenë në vendin e ngjarjes, përfshi edhe Gjergji Oshafin. Në këtë seancë u diskutua në lidhje me akuzën dhe kompetencën e Krimeve të Rënda për shqyrtimin e dosjes, e cila përfundimisht do të gjykohej për akuzën e "Vrasjes së punonjësve të Policisë së Shtetit", kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, "Prodhim dhe shitje narkotikësh" dhe "Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake".

Hidhet në erë me tritol Ujësjellësi në Delvinë

SARANDE - Hidhet në erë me tritol depoja e Ujësjellësit në fshatin Kopacez në Delvinë. Ngjarja ka ndodhur mbremjen e së mërkurës rreth orës 21:00. Mësohet se Ujësjellësi ishte ndërtuar prej 16 vitesh, ndërkohë që dy ditë më parë u vu në punë për herë të parë. Ai furnizonte me ujë gjysmën e fshatit, ndërsa pjesa tjetër furnizohej nga burimi pretendonte se venia në punë e Ujësjellësit do shteropte burimin dhe pas kësaj, ata do të detyroheshin të furnizohen me ujë nga ujësjellësi, ku do të paguanin edhe një tarifë të caktuar. Policia ka shkukur në vendngjarje dhe ka nisur hetimet për dokumentimin e plotë të saj.

Luante skedina në lokal, procedohet

penalisht menaxheri DURRËS - Edhe pse lojërat e fatit janë ndaluar me ligj që nga dhjetori i vitit të kaluar, ka ende persona që e ushtrojnë këtë aktivitet. Për këtë, policia e Durrësit raporton se një shtetas është proceduar penalisht për veprën penale të ushtrimit të lojërave të fatit në mënyrë të paligjshme. Bëhet fjalë për I.B., 29 vjeç, i cili iu konstatua duke luajtur me bilete loto sporti brenda lokalit që menaxhonte. Ndërkohë, burime nga policia bëjnë me dije se vijojnë kontrollet në të gjithë qarkun Durrës për ndëshkimin e personave, që ende të ushtrojnë aktivitetin e kundërligjshëm të lojërave të fatit.

I pandehuri Nehat Foljeta: Ernest Gjoka më fyeu rëndë, ndaj e godita

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Dhuna ndaj ish-trajnerit të "Vllaznisë", merret në pyetje si dëshmitar Asmer Bilali

29-vjeçari, gjyqtarëve: A ju vjen turp që mbani këta dy djem për një shpullë

Asmer Bilali, djali i Astrit Bilalit, i cili pak ditë më parë u ekzekutua në një atentat së bashku me të vëllain, Brahimin, ka mbërritur sërish në Shkodër. I shoqëruar nga forca të shumta policie, 29-vjeçari është dërguar nga Drejtoria e Burgjeve nga Tirana drejt vendlindjes paraditen e djeshme. Kësaj here për të dëshmuar në gjyqin që zhvillohet për ngjarjen ndaj ish-trajnerit të Vllaznisë, Ernest Gjoka, i cili u godit nga një person në kohën kur drejtonte kuqeblutë. Ngjarje kjo e ndodhur në shkurt të 2018-ës. Si për ironi të fatit, dy ditë më parë u kërcënua trajneri i Vllaznisë, Agim Canaj, duke i vendosur duart në fyt për mosaktivizim të një prej lojtarëve. Në Gjykatën e Shkallës së Parë në Shkodër u zhvillua gjyqi i radhës ndaj shtetasit Nehat Foljeta, i akuzuar për vrasje me paramendim e mbetur në tentativë ndaj ish-trajnerit të Vllaznisë, Ernest Gjoka dhe shtetasit Sehar Xhenje, i akuzuar si bashkëpunëtor në këtë ngjarje. Asmer Bilali i gjendur nën masën "arrest me burg" mori pjesë në seancë si dëshmitar i ngjarjes të një viti më parë. Ai dëshmoi, pasi makina që përdoriin dy të akuzuarit, Nehat Foljeta dhe Sehar Xhenje për t'u larguar pas kërcënimit të Gjokës ka qenë e tij. "Duke qenë se kisha vëllain e sëmurë, automjetin që kam pasur në përdorim ia kam lënë shokut tim, Sehar Xhenje për të kryer nevojat familjare", është shprehur Bilali para togave të zeza. Sipas policisë, Nehat Foljeta kanosi dhe goditi trajnerin e ekipit të futbollit "Vllaznia" asokohe. Më pas ai u largua me njëjin tip "Benz" me targa AA 282 KR ngjyrë të zeze, ku drejtues ka qenë Sehar Xhenja dhe që i përkiste Asmer Bilalit. Nga ana tjetër, shtetasi Sehar Xhenje mohoi në sallën e gjyqit se ka pasur dijeni për goditjen e ish-trajnerit të Vllaznisë, Ernest Gjoka. Xhenje tha se thjesht



29-vjeçari, Asmer Bilali



Ish-trajneri, Ernest Gjoka

DËSHMIA E DY TË PANDEHURVE
I pandehuri Sehar Xhenje mohoi në sallën e gjyqit se ka pasur dijeni për goditjen e ish-trajnerit të Vllaznisë, Ernest Gjoka. Xhenje tha se thjesht ka shoqëruar shokun e tij, Nehat Foljeta te fusha sportive "Reshit Rusi", pasi ia ka kërkuar një gjë të tillë. Edhe Foljeta, që akuzohet për "vrasje me paramendim" e mbetur në tentativë mohoi akuzat ndaj tij. Foljeta pretendon se duke dalë nga fusha sportive i është drejtuar ish-trajnerit të Vllaznisë, duke i thënë se "po na e fundos Vllazninë" dhe pas kësaj shprehej, sipas të dyshuarit Ernest Gjoka e ka fyer dhe e ka sharë rëndë atë.

VRASJA E VËLLEZËRVE BILALI
Pak ditë më parë u ekzekutuan në një atentat në Shkodër vëllezërit Asrit dhe Brahim Bilali, përkatësisht babai dhe xhaxha i ish-kampionit të boksit të Vllaznisë, Asmer Bilali. Ata u qëlluan për vdekje në një atentat mafioz me breshëri kallashnikov. Ndërkohë, në ceremoninë mortore të dy vëllezërve mori pjesë Asmer Bilali, i cili njihet si një nga anëtarët e grupit "Bajri". Asmer Bilali u dha leje nga burgu të marrë pjesë në varrim. Të paktën 3 burigonë dhe makina të tjera policie shoqëruan Asmer Bilalin në ceremoninë mortore.

ka shoqëruar shokun e tij, Nehat Foljeta, te fusha sportive "Reshit Rusi", pasi ia ka kërkuar një gjë të tillë. Foljeta që akuzohet për "vrasje me paramendim" e mbetur në tentativë mohoi akuzat ndaj tij. Foljeta pretendon se duke dalë nga fusha sportive i është drejtuar ish-trajnerit të Vllaznisë duke i thënë se "po na e fundos Vllazninë" dhe pas kësaj shprehej, sipas të dyshuarit Ernest Gjoka, e

thjesht një konflikt i castit, pasi ish-trajneri e ka fyer atë. Edhe i dyshuari si bashkëpunëtor, Sehar Xhenje shprehet se nuk ka pasur asnjë dijeni se çfarë do të ndodhte. Në fund të kësaj seance, dëshmitari Asmer Bilali u drejtua gjykatës duke i thënë "a ju vjen turp që mbani këta dy djem për një shpullë". Pala mbrojtëse kërkoi për shtetasin Nehat Foljeta gjykim të shkurtur

Sulmi me armë në Fier, makina e gjedhur në Elbasan
FIER - Zbardhen të tjera detaje për sulmin me armë që ndodhi mbremjen e së mërkurës në qytetin e Fierit. Makina e autorëve, e cila u gjet e djegur në lagjen "Afrimi i Ri" me targa false, dyshohet se është vjedhur në Elbasan. Nuk dihen ende shkaqet pse u qëllua me breshëri kallashnikov në drejtim të një biznesi që merret me pjesë këmbimi të makinave, në afërsi të vendit të quajtur "Kryqëzimi i Parkut". Ndërkohë, pronarët kanë deklaruar në polici se nuk kanë konflikt me askënd. Fatmirësisht, nga ky sulm me armë nuk pati të dëmtuar, përveçse plumbave që kanë depërtuar në objekt. Nga Policia e Fierit raportohet se automjeti tip "BMW" që u dogj nga autorët e pas ngjarjes kishte targa false dhe i përkasin një makine tip "Renault". Ndërkaq, policia e Fierit janë duke hetuar nëse shënjestra ka qenë ndonjë person pranë biznesit apo pronarët vetë. Materiali në lidhje me këtë ngjarje priten i të përcillen prokurorisë së rrethit për hetime të mëtejshme.

TIRANË - Drejtoria i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu ka firmosur një sërë ndryshimesh në radhët e shefave të Komisarivateve në rrethe. Kjo me qëllim dhënien e një impulsit të ri punës së Policisë në parandalimin dhe goditjen e kriminit, si dhe me qëllim promovimin e punonjësve të shpallur fitues në procesin e ngritjes në gradë.
NDRYSHIMET NË RADHËT E POLICISË SË SHTETIT
Kryekomisar Edmond Meshini deri tani shef i Seksionit të Patrullës së Përgjithshme në Komisariatin e Policisë nr.1 Tiranë, transferohet dhe emërohet shef i Komisarariatit nr.3 Tiranë.
Kryekomisar Arben

"Impulsi i ri në punë", Policia e Shtetit ndryshon shefat e komisarivateve në Tiranë dhe në rrethe

Kalaja deri tani shef i Policisë Kriminale në Komisariatin e Policisë Vorë transferohet dhe emërohet shef i Komisarariatit të Policisë Kukës.
Kryekomisar Vullnet Sijaj deri tani shef nënsie në Repartin Special "RESI", Tiranë, transferohet dhe emërohet shef i Komisarariatit të Policisë Gramsh.
Komisar Alfred Maksuti deri tani shef i Komisarariatit të Policisë Gramsh transferohet dhe emërohet shef i Seksionit të Rendit Publik në Komisariatin e Policisë Pogradec.
Kryekomisar Aldi Mema

deri tani shef i Seksionit të Policisë Kriminale në Komisariatin e Policisë Shijak transferohet dhe emërohet shef i Komisarariatit të Policisë Mat.
Kryekomisar Henerigert Mitri deri tani shef i Komisarariatit të Policisë Mat transferohet dhe emërohet shef i Komisarariatit të Policisë Fier.
Komisar Ermal Lilaj deri tani Specialist në Departamentin e Policisë Kriminale transferohet dhe emërohet shef i Komisarariatit të Policisë Peqin.
Komisar Bilal Semanaj deri tani shef i Komisarariatit të Policisë Peqin transfero-

het dhe emërohet shef i Komisarariatit të Policisë Cërrik.
Komisar Gazmend Demirozi deri tani shef i Seksionit të DVP Berat transferohet dhe emërohet shef i Komisarariatit të Policisë Dibër.
Kryekomisar Alfred Cenaj deri tani shef i Sektorit të Komandës dhe Kontrollit në DVP Durrës transferohet dhe emërohet shef i Komisarariatit të Policisë Mirditë.
Kryekomisar Medin Hasani deri tani shef i Komisarariatit të Policisë Mirditë transferohet dhe emërohet shef i Komisarariatit të Policisë Skrapar.
gracionit transferohet dhe emërohet shef i Komisarariatit të Policisë Tepelenë.
Kryekomisar Petrit Gjokaja deri tani specialist në Departamentin e Policisë Kriminale transferohet dhe emërohet shef i Komisarariatit të Policisë Përmët.



Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu

Ministrja e Financave, Anila Denaj: Rriten pagat për mësues, mjekë, infermierë e ushtarakë

Denaj: Rriten pagat për 65 mijë punonjës, tabela për çdo punonjës

Shtesa mbi pagën, nga 1 prilli në masën 7% deri në 20%

Nga prill nis rritja e pagave për 65 mijë punonjës të administratës publike, mjekë, mësues, infermierë ushtarak dhe policë burgjesh. Rritja varion nga 7% deri në 20% mbi pagën në varësi të pozicionit. Lajmi është bërë i ditur nga ministrja e Financave dhe Ekonomisë, Anila Denaj, e cila shprehet se rritja e pagave në vitin 2019, një tjetër premtim i mbajtur i qeverisë shqiptare. "Sikurse është bërë e ditur gjatë procesit të miratimit të buxhetit 2019, punonjës të disa sektorëve të rëndësishëm do të përfitojnë rritje të qenësishme të nivelit të pagave të tyre. Kjo rritje do të aplikohet duke filluar nga data 1 prill 2019"-shkruan Denaj.

KATEGORITË

Janë pesë kategori punonjësish që do të përfitojnë rritje page. Ministrja e Financave Anila Denaj bën të ditur se nga 1 prilli i këtij viti përfitojnë rritje page 36 mijë mësues të Arsimit Parashkollor, Arsimit Bazë, Arsimit të Mesëm të Përgjithshëm dhe atij Profesional do përfitojnë rritje të pagës prej 7%. Rritja e pagës ka hyrë në fuqi edhe për 4,650 mjekë dhe 13,765 infermierë dhe staf shëndetësor, shtesa mbi rrogën është llogaritur dhe staf mesatare të pagës mujore në masën 7%. Rritje page është aplikuar edhe për 6,800 ushtarakë, të cilët përfitojnë një rritje mesatare të pagës mujore në masën 7%. Sipas ministres së Financave janë dhe 3,560 punonjës të sistemit penitenciar (policia e burgjeve) të cilët përfitojnë një rritje mesatare të pagës mujore me 7%. Gjithashtu, 308 punonjës të përfaqësive diplomatike jas-



Ministrja e Financave, Anila Denaj

htë vendit të cilët përfitojnë një rritje të diferencuar të pagës mujore që shkon nga 7-20%.

PËRFITUESIT DHE FONDI

Në total, parashikohet që të përfitojnë mbi 65 mijë punonjës buxhetorë, me një kosto vjetore në buxhetin e shtetit prej 3 miliardë lekë. "Qeveria shqiptare mbetet e angazhuar për të vazhduar politikën e rritjes domethënëse të pagave në administratën publike, pasi e konsideron si një element kyç në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike ndaj qytetarëve"-thotë ministrja e Financave.

PAGAT

- 36 mijë mësues të Arsimit Parashkollor, Arsimit Bazë, Arsimit të Mesëm të Përgjithshëm dhe atij Profesional do përfitojnë rritje të pagës prej 7%
- 4,650 mjekë dhe 13,765 infermierë dhe staf shëndetësor, një rritje prej 7%
- 6,800 ushtarakë të cilët përfitojnë një rritje mesatare të pagës mujore në masën 7%
- 3,560 punonjës të sistemit penitenciar (policia e burgjeve) të cilët përfitojnë një rritje mesatare të pagës mujore me 7%
- 308 punonjës të përfaqësive diplomatike jashtë vendit të cilët përfitojnë një rritje të diferencuar të pagës mujore që shkon nga 7-20%;

Spiropali: Opozita, probleme serioze me njohuritë. PD: Rama mashtroi, nuk i rriti pagat e mësuesve e mjekëve

PD-ja akuzoi dje kryeministrin Edi Rama se mashtrroi mësuesit, mjekët, infermierët e ushtarakët për rritjen e pagave në 1 prill. Ish-deputetja Albana Vokshi i kërkoi qeverisë që të miratojë menjëherë një VKM me fuqi prapavepruese që kjo kategori profesionale të përfitojë rritjen e pagës. "Ne telefonin tim janë me qindra mesazhe të mësuesve, mjekëve dhe infermierëve që shprehin revoltën e tyre për mosmbajtjen e premtimit nga Edi Rama. Partia Demokratike e di shumë mirë se qeveria po fsheh gjendjen e vërtetë të financave të shtetit, se kontrabanda dhe korrupsioni në dogana e tatime gëlojnë dhe në arkë nuk ka para mjaftueshëm, sepse muaji mars është mbyllur me minus, por rreth 60 mijë mësues, mjekë, infermierë, punonjës të shëndetësisë, ushtarakë dhe familjet e tyre, nuk kanë pse të vuajnë pasojat e korrupsionit galopant të qeverisë së Edi Ramës. Zgjidhja është e thjeshtë: qeveria të nxjerrë menjëherë një vendim me fuqi prapavepruese, në mënyrë që rritja modeste të përfitohet që prej datës 1 prill dhe asnjë ditë më vonë", tha zj. Vokshi. Por Ministrja e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, njëkohësisht zëdhënëse e qeverisë, Elisa Spiropali i kujtoi Vokshit që rritja e pagave për të gjithë mësuesit, mjekët do të pasqyrohet në pagën e marrë në muajin maj. "I kujtojme PD që pagat e muajit prill paguhen në maj kur dhe do të jetë e reflektuar rritja për mësues e mjekë. Si duket, dalja nga parlamenti shkaktoka probleme serioze edhe me njohuritë mbi institucionet e tjera shtetërore", u shpreh zj. Spiropali.

VKM, Ja kush janë 7 anëtarët e Këshillit të

Agjencisë së Kadastrës
Këshilli i Ministrave ka miratuar listën e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Referuar vendimi të djeshëm mësohet se anëtarë janë: Majlinda Dhuka, përfaqësues i Kryeministrit; Përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Sekretari i Përgjithshëm; Gentian Deva, përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë; Ermira Gjeçi, përfaqësues i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Artan Shkrel, përfaqësues i Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjisë; Klauudio Çollaku, përfaqësues i Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor; Aurora Alimadhi, përfaqësues i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

Vendimi i qeverisë/ Lëvizje punonjësish në administratë

Institucionet ku shtohen punonjësit dhe shkurtime



Teknik të Këshillit Ekonomik Kombëtar. Numri i punonjësve të Kryeministrit reduktohet me 6 punonjës, duke e çuar num-

imit të Pastrimit të Parave shtohet me 6 punonjës, për vitin 2019, duke e çuar numrin e përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në 5 809 punonjës. Sipas VKM-së numri i punonjësve të Ministrisë së Drejtësisë reduktohet me 14 punonjës, të cilët nuk janë punonjës organikë, por i përkasin mjekëve specialistë, që përfundojnë kontratat e specializimit pranë Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Numri total i punonjësve të Ministrisë së Drejtësisë bëhet 5 629 punonjës. Numri i punonjësve të Institutit të Shëndetit Publik reduktohet me 2 punonjës, duke e çuar numrin e përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

në 4 257 punonjës. Numri i punonjësve të Ministrisë së Infrastrukturas dhe Energjisë, për vitin 2019, shtohet me 3 punonjës, duke e çuar numrin e përgjithshëm të këtij institucioni në 929 punonjës. Numri i papërdorur prej 8 punonjësish kalon në shtimin e numrit rezervë të punonjësve të institucioneve qendrore, duke e çuar këtë numër në 24 punonjës. Vendimi përcakton se në programin "Shërbime të tjera", për Sekretariatit Teknik të Këshillit Ekonomik Kombëtar, shtohet fondi prej 7 000 000 lekësh për shpenzime personale dhe shpenzime operative, për vitin 2019. Në institucionin e Kryeministrit, në programin "Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi" reduktohet fondi prej 7 000 000 lekësh, në zërin "Shpenzime korrente", për vitin 2019.

Ka përfunduar aksioni për mbylljen e gropave gëlqerore në zonën e Krujës. I pranishëm në mbyllje të këtij operacioni, ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi, i cili ka paralajmëruar inspektorët e mjedisit që të kontrollojnë vazhdimisht për të ndaluar tentativat e krijimit të gropave të reja gëlqerore. "Fakti që nuk ka sot asnjë furrë gëlqereje, nuk do të thotë që nuk do të ketë tentativat të tjera, por për këtë ne



Mbyllet aksioni i furrave gëlqerore në Krujë

Klosi: Përgjegjësi penale për inspektorët që lejojnë rikrijimin e tyre

jemi të mirangazhuar që inspektorët e mjedisit, të rendit dhe agjencisë së zonave të mbrojtura të jenë gjithmonë në terren dhe të kontrollojnë në vazhdimësi nëse do të ketë tentativë për të krijuar gropa të reja

gëlqerore", tha ministri Klosi. Ndërsa deklaroi se beteja kundër ndotësve të mjedisit do të vijojë dhe kontrollet do të ashpërsohen, kërkoi bashkëpunimin e qytetarëve për të informuar çdo tentativë për rikrijimin e tyre. "Nga

sot, ne do të kemi kontroll të rreptë të territorit, por pa qytetarët kjo punë do të jetë e vështirë të realizohet. Megjithatë, inspektorët do të mbajnë përgjegjësi penale, nëse do të ketë një grupë gëlqerore në këtë zonë.

Për sa i përket atyre që na kritikojnë, atyre që protestojnë sot, jemi këtu në Zgërdhesh, në një nga 100 fshatrat, një nga zonat që vjet me vendim qeverie ne e kemi shpallur zonë të mbrojtur, ndërsa paraardhësit tanë në pushtet, pra partia demokratike e shpalli zonë industriale dhe gjithë kjo zonë sipas vendimarrjes së qeverisë së kaluar do të ishte bërë një kantieri i madh ndërtimi", u shpreh Klosi.

Rishikohen dhe riformulohen 4870 pyetjet zyrtare të testit teorik

Ndryshon testi i patentës, hiqen 1000 pyetje problematike

Testi i lejes së drejtimit, monitorim 'online' në 13 drejtori

Ndryshojnë pyetjet teorike për testin e lejes së drejtimit të automjeteve, janë hequr 1000 pyetje dhe janë korrigjuar 1500 të tjera. Ndërkohë 13 drejtori të Shërbimeve të Transportit Rrugor do të monitorohen online gjatë testimit të kursantëve. Lajmi është bërë i ditur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit.

NDRYSHIMET

Autoriteti Rrugor ka rishikuar testin e patentës, duke hequr nga lista 1000 pyetje të konsideruara si ngatërrestare. Gjithashtu, ky dikaster bën me dije se 1500 pyetje të tjera janë korrigjuar, pasi kishin në përmbajtje të tyre gabime drejtshkrimore apo edhe fjalë tepër. Marrja e këtyre masave erdhi pas një rishikimi të 4870 pyetjeve zyrtare të testit teorik, pas një shqetësimi të vazhdueshëm të aplikantëve të rinj, të cilët në shumë raste jepnin përgjigje të gabuara për shkak të pyetjeve problematike. Rishikimi i testit u paralajmërua më herët edhe nga drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve të Transportit Rrugor, Blendi Gonxhja, i cili bëri të ditur pak ditë më parë se deri më tani ka patur pyetje, që ngatërrojnë aplikantët apo nuk përshateshin me realitetin e qarkullimit të automjeteve në vendin tonë. Ndërkaq, një tjetër risi në drejtim të testimit për pajisje me leje drejtim lidhet me monitorimin live të të gjithë procesit në 13 drejtoritë rajonale. Sipas DPSHTRR-së tashmë specifikimet dhe financimi për sistemin e ri të monitorimit online janë



Foto ilustruese

gati. Paralelisht, aplikantët mund të ushtrohen edhe online, në faqen zyrtare të institucionit për testimin teorik, një shërbim që deri më tani nuk ishte i mundur.

TESTIMI

Një vit më parë ka hyrë në fuqi vendimi për testin e patentës, ku gabimet e lejuara për të marrë teorinë do të jenë deri në 4. Instruktorët thonë se kushti me 4 gabime është penalizues për disa kategori që e kryejnë më vështirësisë sociale dhe ekonomike kursin e lejes së drejtimit. Duke filluar 1 marsi i vitit të shkuar drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor ka bërë drejtimin teorik në ri për lejedrejtimin të kategorisë A1, A2, B1, dhe B. Zyra përkatëse e DRSHTRR-së, pas dorëzimit të dokumenteve nga përfaqësuesi i autoshkollës, miraton regjistrimin e kan-

didatit në kursin e përgatitjes teorike pasi shqyrton plotësimin e kriteveve si kërkesat

e moshës minimale dhe maksimale, në varësi të kategorisë së lejedrejtimin siç përcak-

MASAT

Autoriteti Rrugor ka rishikuar testin e patentës, duke hequr nga lista 1000 pyetje të konsideruara si ngatërrestare. Gjithashtu, ky dikaster bën me dije se 1500 pyetje të tjera janë korrigjuar, pasi kishin në përmbajtje të tyre gabime drejtshkrimore apo edhe fjalë tepër.

tohet në Udhëzimin dhe në dispozitat e Kodit Rrugor për moshën maksimale dhe të

mos këtë vendim të autoriteteve kompetente, për ndalim pajisje të kandidatit me lejedrejtimin. Kandidati duhet të jetë i pajisur me kategorinë e duhur të lejedrejtimin që mundëson kalimin në kategorinë e lejedrejtimin që kërkohet siç parashikohet në Lidhjen 2 të Udhëzimit Nr. 682/4, datë 1.4.2017 dhe të mos jetë në proces përgatitje teorike për kategori tjetër. Sipas udhëzimit kandidatit që do të pajiset me leje drejtim të mos jetë në proces përgatitje praktike për asnjë kategori tjetër, përveç kategorisë A1, A2 dhe A si dhe të ketë minimalisht një pikë nga gjendja e pikëve si dhe të mos ketë lejedrejtimin të hequr.

Njoftimi i Policisë dhe ARRSH: Nisin punimet të mbikalimi i Fushë-Krujës, ndryshon lëvizja e mjeteve



jtësi të reduktuar, lëvizja e mjeteve do të drejtohet në 2 korsi (nga 1 korsi për secilin drejtim) dhe do të realizohet në përputhje me sinjal-

istikën e vendosur sipas Planit të Menaxhimit të Trafikut të miratuar. Punojësit e Autoritetit Rrugor Shqiptar, Policisë së Qarkullim-

it Rrugor dhe kompanisë së mirëmbajtjes do të jenë në terren për mbarëvajtjen e ndërhyrjes dhe orientimin e trafikut sipas planit të menaxhimit të miratuar, për të lehtësuar qarkullimin e mjeteve dhe garantuar mbarëvajtjen e punës në terren" njofton ARRSH. ARRSH dhe Policia e Qarkullimit Rrugor kërkohet mirëkuptimin dhe bashkëpunimin e drejtuesve të mjeteve dhe biznesëve të zonës gjatë procesit të ndërhyrjes në këtë segment rrugor, respektivisht në mënyrë rigorozë të sinjalistikës provizore të vendosur, rregullat e qarkullimit rrugor, si dhe udhëzimet e Policisë Rrugore në terren.

Njoftim për shitje me ankand të parë
 Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k ka shpallur në datë 28.03.2019 ankandin e parë të pasurisë së palles debitorë SH "Meat Master Vilezenti Kimca" sh.p.k dhe e palles dorezane, e përbërë nga:
 * Njësi me numër pasurie 780 ND e ndodhur në Rr: "M Bickimari" Shkodër e regjistruar në ZK 8593 Regji Hipotekor nr.83 datë 30.10.1988 volum 17, faqe 149 me sipërfaqe 42.75 m². Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar në masën 45.517.3 Euro dyzete e pesëmije e pesëqind e shtatëmbëdhjetë pikë tre Euro)
 Ankandi do të zhvillohet në datë 15.04.2019 ora 15:00 në sallinë Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr.5 Kontakt tel. 0672082543, ilir.dervishaj@yahoo.com, WEB www.powerjustice-al.com

Kompensimi i depozitave në masën 100%, por në çdo rast deri në 2.5 mln lekë

Sejko: Sistemi i sigurimit të depozitave po forcohet

Objektivi i BSH, ruajtja dhe garantimi i stabilitetit financiar

Roli që luajnë siguruesit e depozitave është thelbësor për parandalimin dhe administrimin e krizave, siç është provuar tashmë nga eksperiencat gjatë krizës financiare globale", tha dje Guvernatori Sejko në takimin e Komitetit Rajonal për Evropën të Organizatës Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave. Sejko referoi se është fakt që skemat e sigurimit të depozitave e zbutën krizën e fuditit financiar, duke përdorur çdo instrument në dispozicion të tyre, të tillë si rritja e kufirit të mbulimit të depozitave, zgjerimi i objektivit të skemës së garantimit, dhe ofrimi i pagesave më të shpejta të depozitave të siguruar, madje edhe mbështetje me likuiditet. Rezultati i këtyre zhvillimeve është se, pas periudhës së krizës, u vendos një fokus i ri në lidhje me sigurimin e depozitave. Sigurimi i tyre konsiderohet tashmë si një instrument thelbësor për administrimin e krizave, si dhe një mjet i rëndësishëm për likuidimin me rregull të një institucioni financiar jo të shëndetshëm. Një skemë e mirëndërtuar për garantimin e depozitave jep mbështetje të gjerë për stabilitetin financiar dhe zgjidhjen e krizave financiare, duke zburuar kështu rreziqet dhe duke ruajtur besimin në sistemin financiar, tha Guvernatori. Sipas ligjit në Shqipëri objektivi kryesor i skemës së sigurimit të depozitave është kompensimi i depozitave të depozituesve, në masën 100%, por në çdo rast deri në 2.500.000 lekë për depozituesit në sistemin bankar dhe deri në 2.000.000 lekë për depozituesit në shoqëritë e kursim-kreditit.



Guvernatori Genti Sejko, dje në takimin e Komitetit Rajonal për Evropën të Organizatës Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave

TAKIMI

Mbi pjesëmarrjen e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, në takimin e Komitetit Rajonal për Evropën të Organizatës Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave. Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, mori pjesë në takimin e Komitetit Rajonal për Evropën të Organizatës Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave, i cili u organizua nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD), në bashkëpunim me Organizatën Ndërko-

mbëtare të Siguruesve të Depozitave (IADI), në ambientet e Bankës së Shqipërisë. Në fjalën përshëndetëse të mbajtur në këtë takim, Guvernatori Sejko nënvizoi rëndësinë e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave në zhvillimin e një sistemi bankar të qëndrueshëm dhe të sigurt. Banka e Shqipërisë është jo vetëm autoriteti mbikëqyrës i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, por ka dhënë ndihmesën e saj në ngritjen e kësaj agjencie, me qëllim rritjen e besimit të publikut në sistemin bankar. Më tej,

Guvernatori Sejko duke iu referuar zhvillimeve financiare botërore, theksoi rolin e rëndësishëm të siguruesve të depozitave në parandalimin dhe administrimin e krizave financiare. Një skemë e mirëndërtuar e garantimit të depozitave ndikon në zbutjen e efekteve negative të krizës financiare, çka u vërtetua dhe në krizën e fuditit financiar global. Një ndër objektivat e bankës qëndrore është ruajtja dhe garantimi i stabilitetit financiar. Përmes kësaj një objektivi të tillë mund të

LIGJI PËR SIGURIMIN

Agjencia e Sigurimit të Depozitave është institucion publik i krijuar në vitin 2002, i cili funksionon në bazë të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 "Për sigurimin e depozitave", me mandat administrim e skemës së sigurimit të depozitave në Republikën e Shqipërisë. Objektivi kryesor i skemës së sigurimit të depozitave është kompensimi i depozitave të depozituesve, në masën 100%, por në çdo rast deri në 2.500.000 lekë për depozituesit në sistemin bankar dhe deri në 2.000.000 lekë për depozituesit në shoqëritë e kursim-kreditit.

arrihet nëpërmjet ndërtimit të një rrjeti të mirëkoordinuar të sigurisë financiare, i cili nga ana tjetër duhet të mbështetet nga një kuadër ligjor i qëndrueshëm. Në këtë kontekst, Guvernatori Sejko veçoi se ligji i ri "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme", përcakton Bankën e Shqipërisë si autoritetin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, duke i vendosur në dispozicion mjetet dhe instrumentet e nevojshme për të ndërhyrë në një bankë që gjendet në vështirësi, por pa ndikuar në stabilitetin financiar. Ligji, gjithashtu, ngarkon Agjencinë e Sigurimit të Depozitave me përgjegjësinë për administrimin e fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Në këtë kontekst, Guvernatori Sejko u shpreh se bashkëpunimi ndërmjet in-

stitucioneve dhe aktorëve të tjerë përgjegjës është çelësi i funksionimit të të gjitha masave ligjore të ndërmarra në këtë drejtim. Gjatë fjalës së tij, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Sejko, theksoi rolin thelbësor që ka marrë ndërhyrja e jashtëzakonshme në ruajtjen e stabilitetit financiar, si një ndër shtyllat kryesore të arritjes së sigurisë financiare në vend. Përmes hartimit të planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, krijimi të burimeve të reja të financimit për menaxhimin e krizave financiare, si dhe identifikimit të të gjitha elementeve të nevojshme të gatishmërisë për zbutjen e tyre, Banka e Shqipërisë po hedh hapa të rëndësishëm drejt mbështetjes së një sistemi financiar të shëndetshëm dhe të sigurt.

Një korsi e By Pass-it të Fierit do të jetë e aksesueshme nga automjetet përpara nisjes së sezonit turistik. Punimet janë duke ecur me ritme të shpejta dhe synohet që njëri krah i kësaj njeje të rëndësishme për trafikun drejt jugut të vendit, të jetë gati në fund të muajit qershor. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku, e shoqëruar nga drejtoresha e ARRSH-së, Sonila Qato, ka inspektuar punimet në këtë veprë, ku është njohur nga afër me ecurinë e punimeve. Drejtoresha e Autoritetit Rrugor Shqiptar, Sonila Qato, bëri të ditur se punimet janë duke vijuar sipas grafikut të miratuar nga ARRSH dhe se çdo ditë ky institucion monitoron ecurinë e tyre. "Aktualisht kompania po punon nën grafikun e miratuar nga ARRSH dhe jemi duke monitoruar çdo ditë punimet e kryera nga kontraktori", u shpreh Qato. 240 punonjës, janë angazhuar nga kompania për përfundimin në kohë të punimeve ndërsa ato vi-

Inspekton By Pass-in e Fierit

Balluku: Njëri krah i nyjës hapet për trafikun në qershor



jojnë edhe gjatë natës. Aktualisht po punohet për ndërtimin e tri urave, asaj të Hoxharës, Semanit dhe Pjanit, në dy prej të cilave pritet që brenda muajit prill të vendosen strukturat metalike. "Në 10 prill do të hedhim konstruksionin metalik të urës së Semanit dhe në datën 22 prill, sipas grafikut

të miratuar edhe nga supervizori, do të hedhim urën e Hoxharës. Janë ura të prodhuara në Itali, të ardhura, aktualisht janë gjendje stoku në kantier, dhe po montohen trarë në tokë fillimisht", u shpreh inxhinieri i kompanisë që po kryen punimet. Ministria Balluku ka vlerësuar ecurinë e der-

itanishme të punimeve dhe ka kërkuar nga kompania që të ruaj këtë rritim të punës për të bërë të mundur realizimin në kohë të objektivit për sezonin veror. "Është e rëndësishme, që ne t'i qëndrojmë premtimit që kemi bërë. Deri në 30 qershor kjo rrugë të jetë e hapur për mjetet e tonazhit të lehtë, pra që janë autobusët dhe automjetet e vogla. Nuk do të jetë e hapur për kamionët dhe në 30 qershor premtimi do të mbahet", është shprehur ministria Balluku. Ndërtimi i By Pass-it të Fierit shkurton ndjeshëm distancën mes jugut të vendit dhe kryeqytetit. Hapja e një prej korsive do të bëjë të mundur shmangien e trafikut që krijohet gjatë sezonit turistik në segmentin që kalon përmes unazës së qytetit të Fierit.

Tatimet: Bizneset, procedura të reja për ankim administrativ

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve njofton të gjithë tatimpaguesit për ndryshimet kryesore të procedurave të ankimit administrativ tatimor sipas Paketës Fiskale 2019. Nuk mund të bëhen objekt ankimi: 1-Aktet administrative të bllokimit të veprimtarisë së tatimpaguesit, sipas neneve 41 dhe 122 të Ligjit të sipërcituar; 2-Një detyrim tatimor apo një veprim/mosveprim i administratës tatimore, për të cilin Drejtorja e Apelitit Tatimor apo Komisioni për Shqyrtimin e Apeliteve Tatimore ka vendosur më parë, pavarësisht nëse pasqyrohet në një akt të ri administrativ. Në rast se ankimi dorëzohet pranë një organi jokompetent (për shembull, në zyrën tatimore rajonale ose në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve), afati i ankimit vlerësohet i respektuar nëse kërkesa është paraqitur në kohë pranë organit jokompetent. Nëse detyrimi tatimor që apelohej nuk është paguar dhe për pasojë tatimpaguesi nuk ka vërtetimin e pagesës së detyrimit, atëherë tatimpaguesi, në ankimin me shkrim duhet të dorëzojë garancinë bankare të vënë për detyrimin tatimor. Një kopje e garancisë bankare duhet të dorëzohet nga tatimpaguesi pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore që ka nxjerrë aktin administrativ të ankimit. Shuma e pagueshme ose shuma e vënë si garanci bankare, për detyrimin tatimor objekt ankimi, përfshihet gjatë kamatëvevesat e llogaritura, të përfshira në vlerësimin tatimor të ankimit. Nëse detyrimi në njoftimin e vlerësimit nuk përputhet me vlerësimin e regjistruar në sistemin informatik, tatimpaguesi duhet të paguajë apo vendosë garanci bankare për detyrimin tatimor sipas njoftimit vlerësimit. Me dosjen e ankimit duhet të dorëzohet edhe dokumentacioni që vërteton datën e marrjes së njoftimit vlerësimit të ankimit (kopje të zarfit postar nëpërmjet të cilit është dërguar akti administrativ i ankimit apo konfirmim nga shërbimi postar).

REPORTAZH FËMIJËT ME AFTËSI NDRYSHE

Elira Çanga

"Tungjatjeta" në familjen e Klajdit dhe Donaldit, ndihma që ka munguar prej kohësh

Vajzat e përshëndesin nga makina dhe Klajdi buzëqesh më fort. Ai është 14 vjeç dhe nuk ka shkuar kurrë në shkollë. Nuk mund të ecë, por arrin të përdorë duart. Nëna e tij kujdeset për të gjatë gjithë kohës

Është një mëngjes i qetë marsi dhe kemi mbërritur herët në Librazhd. Duket sikur qyteti sapo është zgjuar, me pak përtesë, për të nisur një ditë të re. Një prej vajzave, që do të takoj sot, e kam njohur një vit më parë ndërsa shkonim në dy familje në fshatrat e Librazhdit, ku ajo zhvillonte seanca fizioterapie për fëmijët me aftësi ndryshe. Çfarë më mbeti në mend në atë kohë ishte qetësia dhe durimi i saj mbresëlënës.

Dorela flet me zë të ulët dhe me të njëjtën qetësi që nuk e kam harruar, ndërsa takohemi pas një viti tashmë në zyrën e vogël në Bashkinë e Librazhdit. Ajo është pjesë e ekipit të "Tungjatjeta", nismë e World Vision që prej prillit të kaluar. Bashkë me dy kolege të saj, u vjen në ndihmë familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara, në Librazhd si dhe fshatrat përreth.

Ky është një mision jo pak i mundimshëm e sfidues, por koleget e saj, Moza, psikologe dhe Eva, logopede, me një buzëqeshje të singertë në fytyrë, më thonë se është edhe "tepër shpërblyes".

"Kur sheh buzëqeshjen e fëmijëve ndërsa ne punojmë me të është një nga momentet më të lumtura"- më thonë ato.

Zyra e vogël e hapur një vit më parë në Bashkinë e Librazhdit, është e mbushur me lodra dhe mjete didaktike dhe vajzat me një shpejtësi të çuditshme e "zbarkojnë" gjithë zyrën në makinë. Vazhdojmë udhëtimin bashkë drejt Hotolishtit dhe pas njëzet minutash mbërrim përpara shtëpisë së Klajdit, sipër, në kodër.

Ka dalë të na presë, shoqëruar nga nëna e tij, Ligja, me një buzëqeshje të përvijuar në fytyrë. Vajzat e përshëndesin nga makina dhe Klajdi buzëqesh më fort. Ai është 14 vjeç dhe nuk ka shkuar kurrë në shkollë.

Nuk mund të ecë, por arrin të përdorë duart. Nëna e tij kujdeset për të gjatë gjithë kohës. Është një grua e fortë dhe me shumë kurajë. Jeta nuk është e lehtë këtu. Babai i Klajdit e ka lënë fshatin dhe punon në Greqi, sa herë i jepet rast për të siguruar jetesën për familjen, Klajdin, vëllain dhe nënën e dy fëmijëve.

"Mirë se erdhët! Po ju prisim që herët",- thotë ajo. "Kemi bërë disa ushtrime jav-



Klajdi Alliu, 14 vjeç, nga Hotolishti, Librazhd

ën e kaluar, por asgjë nuk zëvendëson ato që bën ti, Dorelë",- thotë me butësi Ligja.

Dorela nis ushtrimet me durim, ndërsa Ligja më tregon se sa ka ndryshuar Klajdi gjatë vitit të fundit.

"Mua më duket më i qetë... që prej disa muajsh ecën këmba doras; këtë nuk e ka bërë më parë".

Klajdi bën çdo javë fizioterapi me Dorelën, ndërsa famil-

ja ndiqet me një plan të veçantë nga ekipi i World Vision dhe skuadra e "Tungjatjeta".

Dorela thotë se të "ai është rritur përgjendrimi, qesh, sheh në sy, ndihet më i lirshëm dhe jo i kontraktuar, tani edhe zret vetë nga divani".

Më vjen ndër mend ajo çfarë më thanë vajzat: "edhe një ndryshim i vogël te fëmijët është një hap i madh për ne

dhe kjo na bën të ndjehemi mirë".

Fizioterapia ka përfunduar dhe ndërsa përshëndetemi me Klajdin në oborrin e shtëpisë së tij plot diell, nisemi drejt Xhyrës.

Në një shtëpi njëkatëshe, Donaldi, 11 vjeç jeton së bashku me nënën dhe babain, motrën e tij më të vogël si dhe familjen e xhaxhait të tij.

Donaldi nuk lëviz, zhvilli-



Në familjen e Donald Palit, në Xhyrë të Librazhdit

Ekipi ndihmon me seanca terapie çdo javë, 36 fëmijë me aftësi të kufizuara në zonat e thella të Librazhdit

mi i tij ka qenë i mundimshëm gjatë viteve të fundit dhe problemet të shumta.

Nëna e tij, Pranvera, tregon se vite më parë ai papritur u keqësua, pati një bilokim të përgjithshëm. Kjo e trembi tej mase Pranverën, aq sa një vit më parë ishte ende në dilemë për të pranuar ose jo seancat e fizioterapisë.

Sot, ajo sheh ndryshime te Donaldi. "Më duket më i qetë dhe sikur komunikim më shumë me mua. Në fillim trembej, por tani buzëqesh, edhe unë jam më e qetë kur e shoh të kënaqur", tregon nëna e re.

"Vajzat e 'Tungjatjeta' më kanë ndihmuar të gjej një forcë më të madhe brenda vetes, një forcë që nuk mendoja se e kisha",- rrëfen ajo.

Vera e përkëdhel e i flet me dashuri të birit, ashtu si çdo nënë e ai e dëgjon me një dritë të veçantë në sy. Ajo nuk ankohet për asgjë dhe ka shpresë se gjërat mund të shkojnë

edhe më mirë dhe djali do të ketë përmirësim.

Ekipi i "Tungjatjeta" ndihmon me seanca terapie, çdo javë, 36 fëmijë me aftësi të kufizuara në zonat e thella të Librazhdit. Nënata e fëmijëve e vlerësojnë këtë ndihmë tej mase dhe do të donin që numri i seancave të shtohej. Disa prej tyre po mësojnë t'i bëjnë vetë ushtrimet me fëmijët e tyre dhe kjo ndihmon shumë.

Tri vajzat e ekipit kanë mbaruar pjesën e parë të ditës me seancat në shtëpi, një ndihmë që nuk është ofruar më parë dhe po bën ndryshime, sado të vogla për familjet në nevojë.

I pyes nëse janë lodhur... "Jo, tani do të nisim seancat e tjera, por këtë herë në qytetin e Librazhdit".

Ndalem me to duke i përqaftuar. Çfarë më mbetet në mend dhe në zemër është një falënderim i singertë për punën që bëjnë çdo ditë...!

NJOFTIM PUNESIMI

Mundësi punësimi, PËRKTHYES TURQISHT.
Adresa: Pashaliman, Oriukm. Shtabi i Ekipit në Shqipëri kërkon të punësojë me kontratë përkthyes Turqisht.
Nr i kontaktit: Cel:0676525266.

Shoqëria përbarimore JUSTITIA

Shoqëria përbarimore JUSTITIA shpall ankandim, faza e dytë - për shënjim e pasurisë së paluajshme për të cilën ka vënë hapoleku BKT BANK, më kejo të dhëna:

0 Pasuria "ARE" nr. 175, Zona Kadastrale 3339, me sipërfaqe 7780 m² faqe 190 vol.5, e ndodhur në Vrin Durrës, në pronësi të Z.Adlitan Sefer Kapllani dtl.08.03.1969, që Merita Mycazer Kapllani dtl.24.06.1970 Në vlerën 8.120.000 (tetë milion e njëqind e njëzetë mijë) Lekë.
0 Pasuria Apartament me sip.120m² nr.pas.47/150-1-1 z.k.8518 vol.116 fq.54 me adresë:Plazh 113 Durrës në pronësi të Z.Adlitan Sefer Kapllani dtl.08.03.1969. Në vlerën 3.767.295 (tre milion e shtatëqind e shtatë mijë e dyqind e nientëdhjetë e nientë) lekë.

Ankandi zhvillohet në datën 11.04.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbaruesit gjyqësor me adresë: Bulevardi "Bajram Curri", Pall. 21,Shk. 3, Ap. 18, Tiranë.

Gna ana e Shoqërisë "Sherbimi Përbarimore AB" Shpk është shpallur ankandi faza e dytë për pasurinë e mëposhtme:

1-"Apartamenti" me sipërfaqe totale 125 m² me Nr.pasurie 4/634-1-42 në Zonen Kadastrale 8602 Volumi 16 Faqe 109 e ndodhur në Vlorë. Cnimi fillestar për shitjen në ankand të pasurisë është 35.528 (tridhjetë e tete mijë e pesëqind e njëzet e tete) Euro.

Ankandi do të zhvillohet në datë 19.04.2019 në orën 16:00 pranë zyrës së shoqërisë "Sherbimi Përbarimore AB" Shpk me Përbarues Gjyqësor Privat Admir Beqiri të ndodhur në adresën Rr.Bul Zhan Dark Palli.Kulla.1Teknoprojekt Shk.1 Kat.4 Ap.10 Tiranë.

PENSIONET E PLEQËRISË VENDIMI I QEVERISË

Formula e saktë që mund të verifikoni sa para do të merrni për vitet e punës kontributive

Voltiza Duro

Të gjithë të moshuarit në mbarë vendin, mund të njihen me koeficientin e ri të indeksimit, në mënyrë që të mund të përllogarisin masën e pensionit që u takon për vitet e punës me kontribute. 'Gazeta Shqiptare' zbardh sot vendimin e qeverisë mbi miratimin e koeficientit të indeksimit të bazës së vlerësuar. "Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10, paragrafi i dytë, dhe 59, pika 1, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave vendosi që koeficienti i indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit 2017, për efekt të llogaritjes së shumës fillestare mujore të pensionit, të jetë 3,7 për qind", thuhet në vendimin e Këshillit të Ministrave. Në këtë të fundit theksohet se për efekt të llogaritjes së masës fillestare të pensioneve, me datë fillimi pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësuar, të miratuar me vendimin nr.571, shtohen edhe me koeficientin e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi. "Në vitin 2019, pagat mbi të cilat janë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore deri në vitin 2018, pas indeksimit të tyre me koeficientët vjetorë sipas pikave 1 e 2, të këtij vendimi, nuk mund të jenë më të larta se: a) trefishi i pagës minimale në shkallë vendi, prej 26 000 lekësh, e përcaktuar në vendimin nr.809, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", për pagat e periudhës nga viti 1994 deri më 31.12.2001; b) paga maksimale në shkallë vendi, prej 114 670 (njëqind e katërbëdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) lekësh, e përcaktuar sipas kriterëve të paragrafit të fundit të nenit nr.10, të ligjit nr.7703, datë 1.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, për pagat nga viti 2002 e në vazhdim".

Përllogaritja e pensioneve, qeveria miraton koeficientin e ri të indeksimit

Vendimi: Sa do të jenë pagat për vitin 2019-të



KOEFICIENTI

"Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, Këshilli i Ministrave vendosi që koeficienti i indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit 2017, për efekt të llogaritjes së shumës fillestare mujore të pensionit, të jetë 3,7 për qind", - thuhet në vendim.

FORMULA

Për llogaritjen e pensionit përdoret formula: PP (Pensioni i pleqërisë) = PS (Pension Social) * (shumëzuar) vjetërsi kontributive të realizuara/vjetërsi kontributive që kërkohet +1/100* (shumëzuar) vite sigurimi* (shumëzuar)BV (baza e vlerësuar).

MASA E PAGAVE PËR 2019-ËN

Në vitin 2019, pagat mbi të cilat janë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore deri në vitin 2018, pas indeksimit të tyre me koeficientët vjetorë sipas pikave 1 e 2, të këtij vendimi, nuk mund të jenë më të larta se:

- a) trefishi i pagës minimale në shkallë vendi, prej 26 000 lekësh, e përcaktuar në vendimin nr.809, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", për pagat e periudhës nga viti 1994 deri më 31.12.2001;
- b) paga maksimale në shkallë vendi, prej 114 670 (njëqind e katërbëdhjetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) lekësh, e përcaktuar sipas kriterëve të paragrafit të fundit të nenit nr.10, të ligjit nr.7703, datë 1.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, për pagat nga viti 2002 e në vazhdim.

pagave për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar për llogaritjen fillestare të pensioneve", dhe në këtë vendim, harton e shpall tabelën e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësuar për periudhën deri në vitin 1994 dhe për vitet në vazhdim, deri në vitin 2019, dhe ngarkohet për zbatimin e tyre. Ky vendim do të hyjë në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

FORMULA E PËRLLOGARITJES

Formula e përllogaritjes së pensionit të pleqërisë është: Pension social (bazë) plus një shtesë që është 1% për

çdo vit sigurimi, për çdo vit punë, të bazës mesatare të vlerësuar për gjithë periudhën që individi ka paguar kontributet. Një qytetar që ka filluar punën në vitin 1975 deri në 2018-ën, pa ndërprerje, pra ka 43 vite pune me kontribute. Pensioni do të llogaritet nga viti '75 kur individi ka filluar punë për herë të parë, deri në 2018-ën me pagat që ai ka gëzuar. Këto paga referuese i shërbëjnë individit nga dita që ka filluar punë deri në 31 dhjetor të 1993-it e këto paga kanë koeficientët e vet të indeksimit. Baza e vlerësuar për

SIGURIMI

Në rastet kur personi i siguruar ka periudhë sigurimi para dhe pas datës 1.1.1994, baza e vlerësuar llogaritet si mesatare aritmetike e ponderuar e bazës së vlerësuar të periudhave të sigurimit si ish-punonjësi i institucioneve apo ndërmarrjeve shtetërore dhe ish-anëtar i kooperativave bujqësore përpara vitit 1994 si dhe e periudhave të sigurimit si person i punësuar, i vetëpunësuar apo ekonomikisht aktiv pas datës 01.01.1994.

llogaritjen e pensioneve llogaritet si raport i shumës së pagave, për të cilat janë paguar kontributet, me periudhën që njihet si periudhë sigurimi. Për periudhën e sigurimit nga data 1.1.1994 e në vazhdim, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merret shuma e pagave, për të cilat janë paguar kontributet nga data 1.1.1994 deri në fund të periudhës së sigurimit. Për periudhën e sigurimit në institucione dhe ndërmarrje shtetërore para datës 1.1.1994, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merren pagat referuese, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Për periudhën e sigurimit në ish-kooperativat bujqësore, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merren pagat referuese të caktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave. Në rastet kur personi i siguruar ka periudhë

sigurimi para dhe pas datës 1.1.1994, baza e vlerësuar llogaritet si mesatare aritmetike e ponderuar e bazës së vlerësuar të periudhave të sigurimit, si ish-punonjësi i institucioneve apo ndërmarrjeve shtetërore dhe ish-anëtar i kooperativave bujqësore përpara vitit 1994 si dhe e periudhave të sigurimit si person i punësuar, i vetëpunësuar apo ekonomikisht aktiv pas datës 01.01.1994. Për efekt të llogaritjes së pensioneve me datë fillimi pas 1.1.2016 e në vazhdim, baza e vlerësuar mesatare do të llogaritet bazuar në pagat referuese sipas llojit të punës ose funksionit përpara datës 01.01.1994 si edhe mbi pagat individuale mbi të cilat janë paguar kontributet sipas viteve, nga 01.01.1994 deri në 31.12.2015, të indeksuara me indeksin që del nga pjesëtimi i pagës minimale në shkallë

vendi të vitit 2015 me pagën minimale të vitit 1994 ose me pagën minimale të vitit përkatës. Koeficientët e indeksimit sipas viteve përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave. Koeficienti i indeksimit para vitit 1994, aktualisht është 8.59. Për llogaritjen e pensionit përdoret formula: PP (Pensioni i pleqërisë) = PS (Pension Social) * (shumëzuar) vjetërsi kontributive të realizuara/vjetërsi kontributive që kërkohet +1/100* (shumëzuar) vite sigurimi* (shumëzuar)BV (baza e vlerësuar).

BAZA E VLERËSUAR

Baza e vlerësuar për llogaritjen e pensioneve llogaritet si raport i shumës së pagave, për të cilat janë paguar kontributet, me periudhën që njihet si periudhë sigurimi. Për periudhën e sigurimit nga data 1.1.1994 e në vazhdim, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merret shuma e pagave, për të cilat janë paguar kontributet nga data 1.1.1994 deri në fund të periudhës së sigurimit. Në rastet kur personi i siguruar ka periudhë sigurimi para dhe pas datës 1.1.1994, baza e vlerësuar llogaritet si mesatare aritmetike e ponderuar e bazës së vlerësuar të periudhave të sigurimit si ish-punonjësi i institucioneve apo ndërmarrjeve shtetërore dhe ish-anëtar i kooperativave bujqësore përpara vitit 1994 si dhe e periudhave të sigurimit si person i punësuar, i vetëpunësuar apo ekonomikisht aktiv pas datës 01.01.1994.

"CRCA Albania" zbardh shifrat tronditëse para OKB-së

Raporti: Rreth 77% e fëmijëve në Shqipëri kanë provuar dhunën, 12% e tyre ngacmimet seksuale

15

MIJË FËMIJË

Rreth 15,000 fëmijë shqiptarë janë jashtë shkollës, rreth 22% e fëmijëve romë që i përkasin grupmoshës 10-18 vjeç nuk kanë qenë kurrë në shkollë. Rreth 43% e fëmijëve me aftësi të kufizuara në Shqipëri nuk ndjekin arsimin parauniversitar publik.

gjenden në situatë rruge dhe skllavërie. Vetëm 7.8% e fëmijëve me aftësi të kufizuara kanë akses në shërbime të spe-

cializuara. 50,000 fëmijë në Shqipëri shfrytëzohen për punë! Mbi 60% e fëmijëve raportojnë internet të pasigurt! - thek-

sohet në raport. Drejtori i "CRCA/ECPAT Shqipëri", Altin Hazizaj, në prezantimin e raportit theksoi se qeveria shqiptare është larg garantimit të të drejtave të fëmijëve. "Pavarësisht përmirësimeve që kanë ndodhur në ligje, në ende shohim me shumë shqetësim që Qeveria shqiptare është tepër larg respektimit dhe garantimit të të drejtave të fëmijëve, sipas standardeve të OKB-së! - tha



Hazizaj.

Arsimi i fëmijëve Situata e arsimit të fëmijëve në Shqipëri zuri një hapësirë tjetër në prezantimin e raportit. Sipas këtij të fundit, më shumë se 100,000 fëmijë në Shqipëri, për shkak të kushteve të vështira ekonomike nuk kanë mundësi të barabar-

ta për të ndjekur rregullisht si kolegët e tyre edukimin publik. Pothuajse 28% e fëmijëve jetojnë në kushte të vështira ekonomike dhe janë nën kujdesin e ndihmës në para dhe më shumë se 50,000 fëmijë që duhet të ndjekin arsimin e detyruar, detyrohen të punojnë.

Mynyr Koni: Si qëndron e vërteta mbi plagjiaturat dhe Paktin për Universitetin

Voltiza Duro

Rektori i UT-së: Ministria e Arsimit ka penguar auditimin, Rama sulmon dhe fyen

"Dekanët nuk zbatojnë detyrimet ligjore"

Një ditë pas akuzave të kryeministrit, rektori i Universitetit të Tiranës, Mynyr Koni ka reaguar ashpër dhe ka theksuar se ky sulm ndaj tij është tendencioz. "Kur dëgjon dhe sheh kryeministrin në takime me lista të porositura të personave që duhet të marrin pjesë në to dhe me pyetje të parapërgatitura nga stafi i tij, dhe që në mënyrë të vazhdueshme, merret, fyen dhe përpigjet të fajësojë për çdo gjë dhe në çdo drejtim vetëm Rektori në Universitetin të Tiranës, vetvetiu të lind pyetja: Cili është, në fakt, qëllimi që, në një kohë kur Shqipëria ka 12 universitete publike, sulmohet në mënyrë kaq tendencioze, të parreshtur, pa u mbështetur në asnjë fakt dhe në asnjë provë konkrete vetëm Rektori i Universitetit të Tiranës?... Si është në fakt e vërteta?", thekson Koni.

AKUZAT MBI MASR

Mynyr Koni në deklaratën e tij ka kërkuar auditim nga ana e Ministrisë së Arsimit mbi Universitetin e Tiranës, proces i cili sipas tij është penguar nga vetë ministria në fjalë. "Në Universitetin e Tiranës nuk ka patur auditim nga ana e Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë. Në mënyrë të vazhdueshme e kam kërkuar publikisht, dhe gjej rastin sot, ta artikuloj përsëri, se kërkoj auditim të Universitetit të Tiranës për 10 vitet e fundit. Pse nuk bëhet auditim në Universitetin e Tiranës?", thotë Rektori i UT-së.

AKUZAT MBI DEKANËT

Lidhur me kontrollin antiplagjiaturë Koni ka bërë me dije se janë vetë dekanët e fakulteteve të UT-së që nuk zbatojnë VKM-në. "Në cilësinë e Rektorit të UT, iu kam kërkuar në rrugë zyrtare të gjitha njëjste kryesore (fakultete/institute) të UT-së, të përcillin listen e personave që kanë mbrojtur disertacionin dhe kanë fituar



Rektori i UT-së, Mynyr Koni



Kryeministri Edi Rama

AKUZAT MBI EKONOMIKUN

"I kam kërkuar dekanit të Fakultetit të Ekonomisë të fillojnë procedurat ligjore të verifikimit, por në asnjë rast nga ky fakultet nuk ka ardhur asnjë përgjigje. Për këtë kam bërë me dije edhe Kuvendin e Shqipërisë. Edhe për këtë e ka fajin rektori i UT!" - shprehet rektori.

grada ose tituj shkencorë të barasvlefshëm me to (kërkesë dhe bashkëpunëtor i vjetër shkencor, etj.) që nga viti më i hershëm që dispononin, duke përcaktuar edhe afatin kohor (data 11 Mars 2019). Përfashuar Dekanin e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, asnjë nga dekanët e fakulteteve të tjera të UT-së, deri më tani,

nuk kanë përcjellë asnjë informacion në lidhje me çfarë ju është kërkuar. Pra, kush e pengon zbatimin e VKM-së? ...Rektori i UT apo dekanët, të cilët, siç edhe duhet t'i keni parë, janë gjithmonë në treshit të parë në takimet e zhvilluara nga Kryeministri dhe dëgjojnë akuzat e tij ndaj Rektorit dhe sigurisht as nuk reagojnë,

por vazhdojnë dhe nuk zbatojnë detyrimet e tyre ligjore si drejtues të njëjste kryesore që i kanë zgjedhur, duke u bërë pengesë për çdo gjë dhe ndaj çdo gjëje", thotë Koni.

PENGESAT NGA EKONOMIKU

Koni bën me dije se nga Kuvendi i Shqipërisë, kanë ardhur disa kërkesa për verifikimin e akuzave për plagjiaturë për disa pedagogë të Fakultetit të Ekonomisë, apo për të tjerë që kanë mbrojtur gradën e tyre shkencore në fakultete të tjera të Universitetit të Tiranës. "I kam kërkuar Dekanin të Fakultetit të Ekonomisë, të fillojnë procedurat ligjore të verifikimit, por në asnjë rast nga ky fakultet, nuk ka ardhur asnjë përgjigje. Për

këtë, kam bërë me dije edhe Kuvendin e Shqipërisë. Dhe për këtë e ka fajin Rektori i UT?", shprehet rektori.

BIBLIOTEKA ELEKTRONIKE

"Implementimi i Bibliotekës Elektronike nuk ka lidhje me sistemin informatik të UT-së. Biblioteka Elektronike do të implementohet nga RASH, ku secili përdorues do të ketë logarinë e tij personale. Megjithatë, shpreh keqardhjen për mosfunksionimin prej kaç kohësh të sistemit informatik për shkak të bllokimit të qëllimshëm të tij nga ana e ish-kancelarit dhe e administratorit, të cilët edhe pas kërkesave të mia të njëpasnjëshme, nuk i filluan procedurat e tenderimit për mirëmbajtjen e këtij sistemi", thotë Koni.

sistemi", thotë Koni.

PAKTI PËR UNIVERSITETIN

"Duke e konsideruar një proces shumë të rëndësishëm implementimin me sukses të "Draftpaktit për Universitetin" për Universitetin e Tiranës, që në muajin janar 2019 ia kam përcjellë fakulteteve, me qëllim konsultimin e tij në të gjitha njësitë bazë dhe strukturat e fakultetit. Ndonëse afati i vendosur për paraqitjen e mendimeve dhe sugjerimeve ishte data 15 Shkurt 2019, mendimet dhe sugjerimet si gjithmonë nuk erdhën as nga Dekani i Fakultetit të Ekonomisë, as nga i Drejtësisë dhe as nga Dekani i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja", thekson rektori i UT-së.

Rrëfhet velina: Raportet e mia me prezantuesit e "Fiks fare", ekrani nuk të konsumon

Artea Bebri:

Nuk i lë gjërat të rrjedhin, kam punuar për të arritur këtu ku jam

"Për prindërit do bëja gjithçka"

Egla Xhemali

Të jesh velina e "Fiks Fare" është fat". Kështu e nis rrëfimin për "Gazeta shqiptare" Artea Bebri. Bukuroshja ndan me ne raportet me dy prezantuesit, Dorian Ramaliun dhe Devis Mukën, si dhe na njeh me jetën përtej ekranit. E apasionuar pas modës dhe ngjyrave, velina simpatike na thotë se aksesoret janë pika e saj e dobët, megjithatë, sa i përket veshjeve ajo ka shpenzuar shumë për një pelerinë. Pasioni i madh për kërcimin e ka bërë që të jetë pjesë e pandashme e ansambllit "Tirana", ku dhe ushtrohet një pjesë të mirë kohe. Mes një jete dinamike Artea arrin të gjejë hapësirë edhe për palestrën, kickboxin e në fund të ditës ndihet mirë që ia ka dalë. Biondja na tregon dhe për dashurinë që ka për lulet e se si kujdeset për to. Velina e Fiks-it është po aq solare sa në performancat e mbrëmjeve të emisionit investigativ. Më tej, Artea pohon se do bënte gjithçka për familjen.



cat e fundit të modës? Veshja më e shtrenjtë që ke blerë?

Më pëlqen të jem e informuar mbi tendencat e fundit të modës, koloret dhe mundohem të jem sa më IN

trendeve dhe pse me duhet të them, që aksesoret janë pika e dobët. Sa i përket veshjes më të shtrenjtë, është një pelerinë. Sot, jam pënduar për zgjedhjen. (qesh)

Cdo të thotë për ty 'ta marrësh jetën si të vjen'?

Unë jam person që nuk i lë gjërat të rrjedhin vetë, punoj fort për të arritur gjithçka dua, më ka rezultuar me suk-

ses.

Situata që të ka bërë të qeshësh me vete?

Situata më komike që kujtoj gjithmonë ka qenë në periudhën kur në mungjes stu-

diuja balet klasik dhe pasdite ushtroja kickbox.

Përtej daljeve në ekran, si është një ditë me Artean?

Besoju që është e njëjta rutinë, si çdo moshatare imja. Dita nis herët, pasi jam në shkollë, dy ditë në javë jam pjesë e Ansambllit Tirana. Ndërsa, gjatë pasditeve më gjen gjithmonë në palestër duke praktikuar kickbox.

Sekreti i linjave perfekte?

Nuk mund ta cilësoj veten me linja perfekte, por mundohem të ushqehem shëndetshëm duke reduktuar sheqerin dhe yndyrat, dhe, gjithashtu, shkoj rregullisht në palestër.

Një pasion që nuk e ke ndarë me publikun?

I dashuroj lulet dhe kujdesem shumë për to. Te kopshti im i vogël, nëse do t'i shikonit trëndafilat e mi, do xhelozonit.

Sakrificat më e madhe që do bëje për hir të familjes?

E kush nuk do të sakrificonte për to. Do të bëja gjithçka. Prindërit e mi janë gjithçka kam.



Si është ndjesia e të qenit velinë?

Ndihem shumë e lumtur dhe me fat, që po shijoj këtë ëndërr. Jam e rrethuar nga njerëz profesionist të talentuar dhe miqësorë. A nuk është fat? Jam vërtetë e lumtur dhe falënderuese.

Mendon se të konsumon ekrani?

Jo, përkundrazi në goftë se kthehesh në një personazh të dashur për publikun gjithçka është për mrekulli, ato nuk do të lodhen kurrë së ndjekuri.

Cdo të thotë të punosh me Devin dhe Dorin? Si janë raportet tuaja?

Janë djem të mrekullueshëm. Na këshillojnë dhe motivojnë çdo ditë, kam mësuar shumë prej tyre gjatë gjithë kësaj kohe. Jashtë studios jemi miq shumë të mirë.

Sa i ndjek Artea tenden-




Festoi ditëlindjen e 27, dhuratat e shtrenjta që ka marrë Adelina Tahiri

Këngëtarja e njohur shqiptare, Adelina Tahiri dje festoi ditëlindjen e 27-të dhe dhuratat për të nuk kishin të ndalur. Ndonëse, dhuratat më të shtrenjta ia bëri bashkëshorti i saj, Serjozha Markov, Adelina është befasuar sërisht. Në imazhin e fundit të ndarë me ndjekësit në 'Instagram', këngëtarja seksi shfaqet me një buqetë të madhe me lule e mjaft e buzëqeshur. Nuk dihet nëse edhe këtë herë këngëtarën shqiptare e ka surprizuar bashkëshorti, por bukuroshja duket më e lumtur se kurrë.




Sa paguhesh për një koncert? Mësoni si përgjigjet Greta Koçi

Greta Koçi është një nga këngëtarët më të dashura për publikun. Ajo së fundmi i është përgjigjur ndjekësve në disa pyetje në llogarinë e saj personale, 'Instagram'. Meqë vazhdon të jetë aktive në mbremje dhe koncerte të ndryshme, ndjekësit e kanë pyetur atë se sa para fiton për një koncert. "Ishte tamam me spec, po janë pak personale këto gjëra dhe sikur nuk tregohen. Më shumë rëndësi ka që kam koncerte kudo ku ka shqiptarë dhe mbushem me dashuri nga çdo koncert që jap", përgjigjet Koçi. Kujtojmë se Greta është goxha aktive në projekte dhe klipe.



Fero bën për Arbenitën atë që çdo vajzë do të donte, ja si reagon bukuroshja


Ka kohë që flitet për ta. Fero dhe Arbenita Ismajli janë një nga çiftet më të dashur nga publiku. Duket se ata kanë një kimi të jashtëzakonshme me njëri-tjetrin dhe nuk hezitojnë ta shfaqin atë edhe nëpër komente të ndryshme në rrjetet sociale, ku ngacmohen shpesh. Arbenita është shumë aktive dhe mjaft e ndjekur në rrjete sociale e fotot e saj tërheqin vëmendjen e të gjithëve. Ditën e djeshme, modelja simpatike ka publikuar një foto, në të cilën shumë vajza mund të gjejnë veten. Në këtë foto, Arbenita shfaqet e përkëdhelur në makinë pasi partneri i saj nuk resht së shkrepuari foto. Kujtojmë se çifti po jetojnë afër njëri-tjetrit më të lumtur se kurrë.



When bae wont stop taking you pics 🤪

Doni të bëheni të pasur? Noizy ju zbulon rregullin

Noizy është një ndër reperët më të mirë shqiptarë dhe gjithmonë është në qendër të vëmendjes të publikut, si për projektet muzikore ashtu edhe për jetën personale. Ai ka një numër të madh fansash dhe koncertet e tij janë të tejmbushura. Noizy është shumë aktiv në rrjetet sociale, ku publikon foto e video të ndryshme si nga profesioni ashtu edhe nga jeta personale. Së fundmi, ai ka bërë një postim ku ka dhënë një mesazh, i cili mund të jetë i vlefshëm për shumë persona. Reperi ka publikuar një shprehje të Warren Buffet i cili thotë: "Në botën e parasë dhe financave ekzistojnë vetëm dy rregulla fundamentale: e para, të fitosh gjithnjë sa më shumë para dhe e dyta, të mos harrosh kurrë rregullin e parë".



NATO, aleanca që është në funksion të krizave

70 vjet më parë, dymbëdhjetë shtete të Evropës e të Amerikës së Veriut themeluan NATO-n. Sot është para së gjithash Trumpi që mbjell dyshime, nëse ka të ardhme njëra nga aleancat ushtarake më të suksesshme të historisë. NATO-ja ekziston në Evropë për t'i mbajtur "rusët jashtë, amerikanët brenda dhe gjermanët poshtë". Këtë e ka deklaruar dikur në një ambient shoqëror, sekretari i parë i Përgjithshëm i NATO-s, lordi britanik Hastings Ismay. Me këtë ai shqiptoi një pikëpamje të përhapur të viteve të para: nga Lufta e Dytë Botërore e nisur nga Gjermania kishin kaluar vetëm pak vjet, Bashkimi Sovjetik kontrollonte të gjithë gjysmën lindore të Evropës, duke përfshirë edhe pjesën lindore të Gjermanisë dhe amerikanët në fillim po mendoheshin a ta linin sërish Evropën të merrej me veten dhe ndoshta nën një ndikim më të madh sovjetik. Por Gjermania nuk u mbajti për shumë kohë "poshtë", të paktën jo pjesa



perëndimore: në vitin 1955 Gjermania u bë anëtare e NATO-s, ndërsa RDGJ hyri në Traktatit e Varshavës të dominuar nga sovjetikët. Lufta e Ftohtë më baraspeshën e saj të frikësimit reciprok zgjati rreth 40 vjet. Gjendja ishte e tendosur, por edhe e qëndrueshme. Në kuadër të negociatave të çarmatimit me Bashkimin Sovjetik, Presidenti i atëherëshëm Roland Reagan deklaroi në vitin 1988 se "në radhë të parë qëndron për mua ruajtja e një partneriteti të fortë dhe të shëndetshëm midis Amerikës së Veriut dhe Evropës. Interesat e

këtij partneriteti në nuk do t'i sakrifikojmë asnjëherë për ndonjë marrëveshje me Bashkimin Sovjetik." 1989/1990 gjendja ndryshoi në mënyrë radikale. Komunizmi pësoi kolaps, Bashkimi Sovjetik u shpërbë. Fuqitë fituese të Luftës së Dytë Botërore ranë dakord që Gjermania të ribashkohet si anëtare e NATO-s. Brenda pak vitesh, shumica e shteteve të Traktatit të Varshavës, si Polonia, Rumania dhe shtetet baltike u bënë anëtare të NATO-s. Ndërkohë është kthyer një situatë e ngjashme si në luftën e ftohtë. Rusia thotë se duhet e kërcënuar nga zgjerimi në Lindje i NATO-s dhe armatoset. Kjo e frenon një zgjerim të mëtejshëm të aleancës. Georgjia dhe Ukraina për shembull mund të kenë pak shpresa për anëtarësim në NATO, sepse Aleanca nuk do konflikte të reja brenda saj. Konfliktet NATO-ja ka mjaft. Që në vitet 1990, ajo angazhohet gjithnjë e më shumë jashtë territorit të Aleancës. Në Gjermani, me

historinë e saj nacionalsocialiste, kjo ngjalli në fillim diskutime të ashpra. Ndërkohë Gjermania merr pjesë në një sërë misionesh në botën e jashtme, për shembull në Ballkan dhe në Afganistan. Një herë të vetme në historinë e saj 70 vjeçare e aktivizoi NATO-ja klauzolën e mbrojtjes reciproke, dhe kjo ndodhi pas atentateve terroriste të 11 shtatorit 2001 në SHBA. Por për pasojat u ndez një grindje e madhe, e cila e përçau NATO-n për shumë vjet. Prej marrjes së mandatit nga Presidenti i SHBA Donald Trump dy vjet më parë, NATO-ja ndodhet sërish nën presion. Trumpi i ka vënë disa herë pikëpyetje kuptimit të ekzistencës së NATO-s dhe detyrimit për mbrojtje kolektive. Në vitin 2018 ai pyeti se për se duhet të mbrojnë SHBA një vend të vogël si Mali i Zi dhe të rrezikojnë me këtë shpërthimin "e një lufte të tretë botërore". Ai ka kërcënuar edhe që mbrojtje amerikane do të ketë vetëm për ata, që

paguajnë sa duhet. Para së gjithash është Gjermania, të cilën ai e ka akuzuar se shpenzon shumë pak për mbrojtjen. Në takimin më të fundit të nivelit të lartë të NATO-s në vitin 2018, Trumpi i zbuti fjalët e tij. "NATO-ja është shumë e rëndësishme, por NATO-ja e ndihmon Evropën më shumë se na ndihmon ne." Kancelarja gjermane Angela Merkel deklaroi në të njëjtin takim se Gjermania i dedikon shumë NATO-s. "Por Gjermania edhe kontribuon shumë për NATO-n. Dhe ne vazhdojmë që deri sot të jemi shumë të angazhuar në Afganistan, dhe me këtë ne mbrojmë edhe interesat e SHBA." Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg paralajmëroi pak kohë më parë: "Nuk është e gdhendur në gur që lidhja transatlantike do të ekzistojë gjithnjë". Por kjo që më tepër nxitje për Berlinin. Stoltenbergu shtoi: "Në historinë e NATO-s kemi pasur shumë ndryshime në mendime, por i kemi kapërcyer ato herë pas here. Sepse në fund ne ramë të gjithë dakord, që Amerika e Veriut dhe Evropa janë më të sigurtë sa bashku".

SHKURT

Rezolutë për një tjetër shtyrje të Brexit

Parlamenti britanik miratoi një rezolutë që detyron kryeministren May të kërkojë në Bruksel një tjetër shtyrje të afatit të Brexit. Rezoluta u miratua me votat e 313 deputetëve të dhomës së ulët dhe mori një votë më shumë se numri i atyre që e kundërshtuan. Rezoluta kërkon shtyrje të afatit të përfundimit të Brexit-it përtej 12 prillit. Shumica e atyre që e mbështetën ishin laboristët, ndërsa konservatorët votuan me shumicë kundër. Votimi erdhi pas takimit që May pati me kreun e laboristëve Jeremy Corbyn të mërkurën, ku diskutua për rrugëzdhjet për çështjen Brexit.

Ish-shefi i

"Nissan" arrestohet përsëri

Ish-drejtori ekzekutiv i "Nissan", Carlos Ghosn është arrestuar përsëri në Tokio, pasi ishte liruar me kusht dhe po gjykohej në liri për akuzat e mashtrimit financiar. Prokurorët thanë se 65-vjeçari është arrestuar sërish pas dyshimeve se ai i ka shkaktuar Nissan humbje me vlerë 5 milionë dollarë. Carlos Ghosn i ka kundërshtuar këto akuzat dhe arrestimin për herë të dytë e ka konsideruar arbitrar, raporton BBC. 65-vjeçari ishte liruar me kusht kohë e fundit pas qëndrimit 108 ditë në paraburgim. Sipas televizionit japonez NHK, prokurorët kishin shkruar në shtëpinë e 65-vjeçarit në orën 06:00 të mëngjesit të së enjtes pasi kanë dyshime se ka shpërdoruar fondet e kompanisë së automjeteve "Nissan" për qëllime personale. "NHK" theksoi, gjithashtu, se në Japoni është e pazakontë që dikush që lirohet me kusht të arrestohet përsëri. Hetuesit dyshojnë për disa transferata të bëra mes viteve 2015-2018, që arrinin vlerën e 15 milionë dollarëve. Nga kjo shumë, dyshohet se 5 milionë dollarë është përdorur për përfitime personale nga ish-shefi i Nissan. Carlos Ghosn ishte drejtori ekzekutiv i Nissan që mundi të krijonte aleancën me prodhuesin francez Renault, ndërsa në vitin 2016 bëri pjesë të bordit edhe kompaninë tjetër Mitsubishi.

28-vjeçari hetohet për lidhje supermaciste të bardha në Gjermani

Vrau 50 persona, akuzat e terroristit të Zelandës së Re

Sulmoi dy xhamitë, sot paraqitet në gjykatë ekzekutori

Pas sulmeve që kreu në dy xhami në qytetin e Kristçerç të Zelandës së Re, australiani Brenton Tarrant, 28 vjeç do të përballlet me akuzat për 50 vrasje dhe 39 për tentativë vrasjeje. Gjithashtu, ai do të hetohet për lidhje dhe ndihmë ndaj grupeve supermaciste të bardha në Gjermani, pasi Bundestagu gjerman ka raportuar se Tarrant kishte financuar grupe të tilla në shtetin gjerman. Pesëdhjetë njerëz u vranë dhe 48 u plagosën nga të shtënat masive në dy xhami, më 15 mars. Idyshuari kryesor i sulmeve, Tarrant, një supermacist i bardhë, do të paraqitet në Gjykatën e Lartë të Kristçerçit ditën e sote, përmes një video-lidhjeje nga qyteti Aukland. Pas ngjarjes, kryeministria e Zelandës Jacinda Ardern mori vendimin që të vendi të ndalojë armët gjysmë-automatike dhe pushkët, shkruajnë mediat ndërkombëtare. Tarrant publikoi masakrën live në "Facebook", duke krijuar probleme edhe për rrjetin social. Ndërkaq para disa ditësh Kryeministria e Zelandës së Re ka përkujtuar viktimat e sulmit terrorist të ndodhur në dy xhamitë në Kristçerç. Jacinda Ardern, ka marrë pjesë në ceremoninë përkujtimore ku të pranishëm ishin 20 mijë persona. Kjo ceremoni u mbajt nën qiellin e hapur, ku e para e ekzekutivit të Zelandës theksoi se "Racizmi nuk ka vend këtu". Gjithashtu, kryeministria e Zelandës së Re, Jacinda Ardern, premtoi të mos thotë kurë emrin e armikut të xhamisë së Kristçerç. "Ai kërkoi shumë gjëra me aktin e tij terrorist, mes tyre dhe famën, prandaj nuk do të më dëgjoni ta përmend emrin e tij", tha Ardern në një fjalim emocional në parlamentin e Zelandës së Re. Ardern tha:



"Ju lutem, flisni për emrat e atyre që kanë humbur, në vend të emrit të njeriut që i mori ato, ai është një terrorist, ai është kriminel, është ekstremist, por ai, kur flas, le të jetë pa emër. Në një takim të veçantë të parlamentit, Ardern përdori përsëritjen arabe "Al-Salaam Alaikum", e cila do të thotë "paqja qoftë mbi ju". Kryeministria u bëri thirrje platformave të mediave sociale që të bëjnë më shumë për të luftuar terrorin, pasi njeriu i armatosur në Kristçerç filmoi sulmin e

tij live në "Facebook". "Ne nuk mund të rrimë duarkryq dhe thjesht të pranojmë se këto platforma ekzistojnë dhe se çfarë publikohet në to nuk është përgjegjësi e vendit ku u publikuan", tha ajo. "Ata janë publikues, jo thjesht postierë. Nuk mund të ketë çështje vetëm përfitimi, pas asnjë përgjegjësi". Ditën tjetër pas masakrës në dy xhamitë e Kristçerç-it, ku mbeten të vdekur të paktën 49 persona dhe 48 të plagosur doli para gjykatës personi që dyshohet të ketë kryer këtë

Rishfaqet pas shtatë vitesh në Kentucky, i mituri: Ia mbatha nga personat që më rrëmbyen

Një djalë 14-vjeç është prezantuar në departamentin e policisë në Kentucky, në SHBA, duke u thënë se quej Timmothy Pitzen dhe se është rrëmbyer në Shtetin e Illinois në 2011, kur ishte vetëm 7-vjeç. "Ja kam mbathur nga dy individë që më mbanin të burgosur"-u ka thënë ai agjentëve të kontenesë së Campbell. Tani i takon testit të ADN-së të konfirmojë ose të përgënesh-trojë deklaratat e adoleshentit. I riu ecte i coroditur në rrugët e Newport, ku edhe ka kërkuar ndihmë nga një grua, e cila më pas e ka dërguar drejt forcave të rendit. Shtfaqja e parë e Pitzen i përket marsit të 2011 në një park uxor në Wisconsin. Nëna e tij ishte nisur të merrte vogëlushin në shkollë pa i thënë asgjë të atit dhe kishte udhëtuar rreth 800 km në dy ditë. Në pak orë gruoja u gjet më pas e vdekur në një motel të Illinois. Pranë trupit të saj, u gjet edhe një letër ku shkruhej se djali i saj ishte i sigurtë me njerëz që do ta donin dhe mbronin. "Kam shumë besim, se ai është mirë dhe në një vend të mirë dhe do kthehet te ne". ka thënë gjyshja e Pitzen, Alana Anderson. Tani 14-vjeçari është dërguar drejt spitalit pediatrik të Cincinnati ku testi i ADN-së do vërtetojë ose përgënesh-trojë dëshminë e tij.

akt terrorist. Autori i dyshuar 28-vjeçari Brenton Tarrant doli para gjykatës, ku u përball me akuzën për vrasje. I veshur me uniformën e bardhë të të burgosurit, Tarrant u shfaq i buzëqeshur dhe

pa asnjë shenjë pendese. Gjatë seancës gjyqësore, ajo që tërhoqi vëmendje ishte sjellja e tij dhe simbolin që ai formoi. Në një moment ai bëri simbolin e grupeve supermaciste të bardhë.

70 vjet NATO, Haradinaj: NATO na mbrojtë nga gjenocidi

Kryeministri kosovar, kërkesë Aleancës: Pas 20 vitesh të jemi pjesë, të ruajmë paqen

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka uruar Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg për 70-vjetorin e nënshkrimit të Traktatit të themelimit të kësaj Aleance. Me një postim në "Facebook", shefi i qeverisë së Kosovës kujton ndihmën e madhe që trupat e NATO-s dhanë për çlirimin e popullit shqiptar nga pushtimi serb. Ai thekson më tej se pas 20 vitesh, Kosova kërkon që të jetë pjesë e aleancës për të kontribuar në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit. "Njëzet vjet më parë, NATO mbrojtëti drejtat e popullit të Kosovës përballë një fushate genocidale të vrasjes dhe terrorit. Populli i Kosovës përherë do t'i jetë mirënjohës ShBA-së dhe shteteve anëtare të NATO-s. Tani, pas dy dekadave, si popull i lirë me orientim të natyrshëm dhe të palëkundur euro-atlantik, ne synojmë që të jemi pjesë e aleancës së shteteve të NATO-s dhe të japim kontributin tonë të plotë në mbrojtjen e vlerave dhe parimeve të sigurisë, lirisë dhe demokracisë", - shkruan Haradinaj.



RAMUSH HARADINAJ

"Si popull i lirë me orientim të natyrshëm dhe të palëkundur euro-atlantik, ne synojmë që të jemi pjesë e aleancës së shteteve të NATO-s dhe të japim kontributin tonë të plotë në mbrojtjen e vlerave dhe parimeve të sigurisë, lirisë dhe demokracisë", - shkruan Haradinaj.

uar në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit. "Njëzet vjet më parë, NATO mbrojtëti drejtat e popullit të Kosovës përballë një fushate genocidale të vrasjes dhe terrorit. Populli i Kosovës përherë do t'i jetë mirënjohës ShBA-së dhe shteteve anëtare të NATO-s. Tani, pas dy dekadave, si popull i lirë me orientim të natyrshëm dhe të palëkundur euro-atlantik, ne synojmë që të jemi pjesë e aleancës së shteteve të NATO-s dhe të japim kontributin tonë të plotë në mbrojtjen e vlerave dhe parimeve të sigurisë, lirisë dhe demokracisë", - shkruan Haradinaj në 'Facebook'.

Eksperti i CEFTA: S'ka mekanizëm dënimi të anëtarëve për shkeljen e marrëveshjes

Taksa, Serbia bën gati betejën ligjore me Kosovën në Arbitrazh

Brambiç paralajmëron: Nis procedimi nëse s'hiqet tarifa

Një gërç i komunikimit Kosovë-Serbi për të çuar përpara dialogun vijon ende. Mesa duket, dialogu mes Kosovës dhe Serbisë ka mbetur në vend për shkak të taksës të vendosur nga qeveria e Haradinajt. Por mesa duket 'heshjtjes' i erdhi fundi, sepse ditën e djeshme, mediat serbe raportuan se Beogradi do të fillojë një betejë ligjore dhe çështjen do ta dërgojë në arbitrazh. "Beogradi zyrtar po shqyrton mundësinë që të nisë procesin e arbitrazhit për shkak të taksës që ka vendosur Kosova ndaj mallrave serbe në nëntorin që shkoi, duke shkelur marrëveshjen CEFTA, shkruan gazeta "Novosti". Ky opsion është në tavolinë që nga 25 shkurti, kur janë bërë 90 ditë nga dorëzimi i kërkesës së qeverisë së Serbisë, që ka dërguar kërkesën formale sekretariatit të CEFTA-s, për konsultime direkte në kuadër të komitetit të përbashkët. Në momentin e dorëzimit të kërkesës kryeministria Brnabić ka paralajmëruar nisjen e procesit të arbitrazhit nëse nuk zgjidhet çështja brenda muajit. Rreth kësaj mësohet se ka pasur takime edhe konsultime me ekspertë të brendshëm edhe të jashtëm, në mënyrë që nëse vendoset për arbitrazh të përgatitet strategjia. Edhe presidenti Aleksandar Vučić ka thënë të hënën se qeveria po zhvillon bisedime në angazhimin e një zyre të avokatorës në rastin e arbitrazhit për shkak të shkeljes së marrëveshjes CEFTA nga ana e Prishtinës. Ende nuk dihet si do të duket kërkesa e Serbisë për nisjen e procesit të arbitrazhit, sikurse nëse do kërkohet kompensim për dëmin e shkakuar nga taksat. Shtrohet pyetja a do të jetë kjo iniciativë vetëm e Beogradit apo e përbashkët me BiH pasi edhe ajo është nënshkruese e CEFTA-s. Zvonko Gobeljić nga Instituti Ekonomik, ka thënë se



ZVONKO GOBELJIĆ

"Vetë arbitrazhi është një proces i gjatë dhe i papërcaktuar edhe në lidhje me zhdëmtimin, Serbia mund të kërkojë, por ka shans të vogël të arrihet ajo", tha Gobeljić.

CEFTA ka dëshmuar se nuk ka mekanizëm dënimi të anëtarëve për shkeljen e marrëveshjes, ndonëse kjo nuk ka ndodhur deri tani kur u vendos taksa nga Prishtina. "Në raport me zgjidhjet tjera, më e mira do të ishte që Prishtina të ndalojë dhe të heq taksën për mallrat serbe dhe kjo mund të bëhet përmes rrugës diplomatike dhe Komisionit Evropian, organizatës botërore tregtare dhe të bëhet presion te shqiptarët që të ndalojnë të shkatërrojnë atë që është ndërtuar nga CEFTA. Arbitrazhi është zgjidhje, gjykata në atë rast do merrte në

konsideratë informatat në lidhje me rastin. Gobeljić tha se vendimi i Gjykatës së Arbitrazhit është obligues: "Vetë arbitrazhi është një proces i gjatë dhe i papërcaktuar edhe në lidhje me zhdëmtimin, Serbia mund të kërkojë por ka shans të vogël të arrihet ajo", tha Gobeljić. Serbia ka përbush të gjitha rregullat e CEFTA-s dhe në nëntor ka kërkuar zgjidhje për taksat dhe është treguar racional, ndërsa në takimin e komitetit të përbashkët në përfaqësuesit e Kosovës dhe Shqipërisë kanë braktisur mbledhjen.

MEDIA SERBE

"Beogradi zyrtar po shqyrton mundësinë që të nisë procesin e arbitrazhit për shkak të taksës që ka vendosur Kosova ndaj mallrave serbe në nëntorin që shkoi, duke shkelur marrëveshjen CEFTA, shkruan gazeta "Novosti".

Gjykata e Hagës refuzon apelin për Karaxhiç

Gjykata për Krime e Kombeve të Bashkuara në Hagë ka refuzuar apelin e fundit të ish-liderit të serbëve të Bosnjës, Radovan Karaxhiç, duke thënë vendimi i këtij trupi ka qenë përfundimtar. Gjyqtarët e Tribunalit kanë thënë më 3 Prill se "Karaxhiç nuk ka asnjë bazë ligjore për të apeluar vendimin", i cili e ka ndëshkuar atë me burgim të përjetshëm për masakrën në Srebrenicë dhe mizoritë tjera gjatë luftës në Bosnjë. Në Srebrenicë janë vrarë më shumë se 8,000 burra dhe djem myslimanë nga forcat serbe të Bonjës, për të shënuar mizorinë më keqe në Evropë prej Luftës së Dytë Botërore. Më 20 mars gjykata i rriti Karaxhiçit dënimin, pasi fillimisht ishte dënuar me 40 vjet burgim. Më shumë se 100,000 persona janë vrarë dhe rreth 2.2 milionë të tjerë janë detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre gjatë luftës në Bosnjë në periudhën 1992-1995.



SHKURT

Makina e merr para në autostradë, vdes 24-vjeçari në Zvicër

Një 24-vjeçar nga Maqedonia e Veriut, emri i të cilit nuk bëhet me dije ka humbur jetën si pasojë e një aksidenti të ndodhur në autostradën zvicerane A1 në Oberbüren SG. Mediat zvicerane raportojnë se një veturë ka goditur dy persona, gjatë mbrëmjes së kaluar në korsinë e emergjencës. Mësohet se viktima kishte ndaluar në korsinë emergjente për të ndihmuar një person tjetër, i cili kishte pasur probleme me gomën e furgonit. Policia ende nuk ka bërë të qartë se si ndodhi aksidenti, ndërsa hetimet vijojnë duke u bazuar edhe tek mbledhja e provave të kamerave në rrugë.

Kosovë, 5 të arrestuar të dyshuar për trafik organesh

Policia e Kosovës arrestoi 5 persona në Prishtinë të mërkurën, nën dyshimet për përfshirje për transplantim ilegal dhe trafik organesh dhe qelizave njerëzore. Njoftimi i policisë thekson se më 2 dhe 3 prill është kryer një operacion në kontrollin e një klinike private në Prishtinë dhe është kryer arrestimi i personave të dyshuar për kryerjen e veprave penale: "transplantimi i paligjshëm dhe trafikuimi i organeve dhe qelizave njerëzore dhe trajtimi i pa-përgjegjshëm mjekësor". Sipas policisë, hetimet filluan disa muaj më parë, ndërsa gjatë kontrolleve u sekuestruan si dëshmi materiale: të dhënat mjekësore, librat e dëshmitarëve, 4 telefona celularë dhe 500 euro para të gatshme. Pas kësaj, autoritetet kosovare morën masa të menjëhershme duke mbyllur klinikën.

Kosova përshëndet heqjen e 'roaming'

Në Kosovë është mirëpritur marrëveshja për heqjen e Roaming-ut me shtetet e Ballkanit Perëndimor që u nënshkrua në Serbi. Eksperti për çështje të telekomunikacionit Agron Dida ka thënë se ky është një hap i rëndësishëm i afrimit të këtyre vendeve të Ballkanit me Evropën. Thotë se negociatat me Serbinë janë shumë të rënda dhe se është sukses që Kosova ka arritur të jetë pjesë e kësaj marrëveshje. Megjithatë operatori Vala aktualisht ka disa probleme teknike të funksionimit të Serbi. Kryetari i Bordit të Autoritetit Rregullativ të Telekomunikimeve Elektronike, ka thënë se problemet janë të operatorëve të Serbisë dhe se janë duke e negociuar këtë çështje. Ai shpreson se shumë shpejt do të arrihet një marrëveshje që të jekalohen këto pengesa.

STUDIMI

Për sa kohë pastrimi prej "mbeturinave" të së shkuarës shikohej si një instrument i pushtetit, ai është njëherazi pjesë themelore e ekonomisë politike të diktaturës, si dhe pjesë e proceseve dhe kulturës holokaustike, aplikuar në emër të modernizmit e në kuadër të kësaj dijeje, edhe kalendarët albanologjikë, indoevropianistë dhe nacionalistë

Etnografia në diktaturë, njeriu si subjekt për t'u bërë

Fatmira Nikolli

"Kultura në modernitet zuri atë vend që kishte pasur feja në shtetin gjathtar"

Prof. Nebi Bardhoshi, leksion në Akademinë e Shkencave të Shën Petersburgut

Si të flasësh për etnografinë realizuar gjatë diktaturës komuniste, pra në kushtin diktatorial, ku si i vëzhguari, ashtu dhe vëzhguesi, ishin në kushtin e aplikimit të diktaturës së proletarietit? Si u gjend kjo dije, kjo imagjinatë etnografike, përballë sfidës për të lexuar, interpretuar etnografikisht proceset sociale e kulturore që ndodhën pas rënies së komunizmit. Ç'po ndodh me dijen etnografike në ditët tona? Prof. as dr. Nebi Bardhoshi, drejtor i Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, Tiranë e ka nisur kështu leksionin e tij me temë "Etnografia në Shqipëri gjatë dhe pas socializmit". Ai foli për këtë studim në Kunstkamera, Akademia e Shkencave e Shën Petersburgut-Rusi. Mes të tjerash, ai trajtoi mënyrën se si u ngjiz dhe u raportua dija etnografike në situatën diktatoriale, tezë kryesore e librit "Etnografia në diktaturë: dija, shteti dhe holokausti ynë", me autorë Nebi Bardhoshi, Olsi Lelaj, 2018. Ndërsa për sfidat që ndeshi "etnografia socialiste" në periudhën post-socialiste dhe në fund u rreth strategjisë kërkimore, projekteve dhe shtigjeve të reja në periudhën aktuale, prof. Bardhoshi u ndal më gjatë.

Këto ishin disa nga pyetjet mbi të cilat u mbështet leksioni i mbajtur në Kunstkamera, në prani të kolegëve dhe pjesëmarrësve të tjerë të interesuar për t'u njohur me zhvillimin e mendimit etnografik gjatë periudhës komuniste dhe pas saj. Leksioni, u zhvillua duke ndjekur këtë linjë. Fillimisht u parashtruan linjat teorike, duke nënvizuar kushtin e modernitetit, duke ndjekur një pikëpamje kritike, por dhe shqyrtese.

Në pjesën e parë, u fol rreth dijes etnografik gjatë socializmit, duke u bazuar kryesisht te libri "Etnografi në diktaturë".

Dijsa, shteti, holokausti ynë. Ndërsa në pjesën e dytë vëmendja u përqendrua te përballja e dijes etnografike socialiste në kushtin post-socialist, dhe në fund rreth idesë se çfarë po ndodh sot me kërkimin etnografik, duke u bazuar kryesisht te strategjia e kërkimit shkencor që po aplikohet në Institutin e Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit.



Prof. as dr. Nebi Bardhoshi, drejtor i Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, Tiranë

ETNOGRAFIA NË DIKTATURË

Në pjesën mbi etnografinë në diktaturë, autori u ndal fillimisht te përvijimi teorik, duke pasur në vëmendje punën e teorianëve, si: Bjon Thommase, Agnes Horvath, Tzvetan Todorov, e veçanërisht të Zigmund Bauman-it. Fjala nisi duke marrë shtysë nga filmi "Look of Silence". Një histori e shkurtër e asaj që sjell dokumentari merret me qëllim për të përballur teorinë e Bauman-it për raportin e holokaustit me modernen, dhe prej këtu për të kaluar te teza se si diktatura socialiste klasifikoi njeriun, shoqërinë dhe kulturën. Në terma të tjerë se si krijoi një situatë ku të gjithë njerëzit u shndërruan në subjekte për t'u bërë. Ky proces shtetëror ku shteti shpalli platformën e një njeriu të ri për t'u bërë, del qartë që territori, ku do të luhej loja e ushtrimit të diktaturës, do të ishte vetë kultura. Siç kishte thënë me mençuri Fitzpatrick (1992), kultura në modernitet zuri atë vend që kishte pasur feja në shtetin gjathtar [koncept i Bauman-it], përkundërt shtetit kopshtar, pra

ai modern. E pikërisht në këtë modalitet shtetëror, u kërkua që të aplikohet më shumë se kurrë, madje për herë të parë në rrugë shtetërore, dija dhe kërkimi etnografik.

KËRKIMI ETNOGRAFIK

Prof. as dr. Nebi Bardhoshi, drejtor i Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit në leksion foli shkurtimisht për historinë e kërkimit etnografik, personazhet kryesorë të kërkimit etnografik, projektet kryesore aplikuar në kërkimin etnografik etj., duke mbajtur fokusin se cilat do të ishin pasqyret leximore të një etnografie socialiste, në fakt, të një etnografie socialiste, së cilës (ashtu si shkencave të tjera sociale e humane) i ishte caktuar kuadri teorik në mënyrë shtetërore. Në librin "Etnografia në diktaturë" është trajtuar me hollësi mënyra shtetërore e prodhimit të dijes etnografike e, konkretisht, se si është shprehur kjo në tekstin etnografik. Konkretisht vëmendje e posaçme i është kushtuar "kronopolitikës, koncept ky i përfutur nga autorët prej punës së Jonatthan



Fabian, Time and the Other. Duke ndjekur këtë shteg, autorët kanë analizuar me vëmendje të posaçme "kalendarët shtetërorë" përkatësisht kalendarët historikë universalë dhe kombëtarë, prejardhur nga pikëpamje materializmit historik, mbështetur nga shteti si dija e vetme shkencore. Si kallëzuesi kryesor, por aspak i vetmuar, është intensiteti i përdorimit dhe kuptimi i dhënë termit "mbeturinë kulturore", term i cili shërbeu jo pak si teknikë e pushtetit. Për sa kohë pastrimi prej "mbeturinave" të së shkuarës shikohej si një instrument i pushtetit, ai është njëherazi pjesë themelore e ekonomisë politike të diktaturës, si dhe pjesë e proceseve dhe kulturës holokaustike, aplikuar në emër të modernizmit e në kuadër të kësaj dijeje, edhe kalendarët albanologjikë, indoevropianistë dhe nacionalistë. U diskutua edhe fakti se dhe pse jemi në kushtin e ushtrimit të etnografisë në kushtin diktatorial, përsëri ka vend për të parë sjelljen e secilit studiues, mënyrës se si ajo apo ai iu shmangj, kërkuan t'i shmanjen apo e përçuan me shumë zell frymën diktatoriale.

PËRBALLJA ME POSTSOCIALIZMIN

Për përballjen e etnologjisë so-

cialiste me atë post-socialiste u dha një panoramë e shkurtër rreth ndryshimeve që ndodhën në objektin, diskursin etnografik, shkaqet që çuan në këto ndryshime dhe për më tepër vëmendja u përqendrua tek përballja e etnologjisë shqiptare bashkëkohore me sfidat për të treguar të shkuarën dhe të tashmen e shoqërisë shqiptare nëpërmjet dijes kritike e reflektive, pa u shqetësuar për të qenë politikisht korrekte. Për të realizuar këtë paraqitje, u paraqitën dhe u analizuan shkurtimisht projektet kërkimore individuale, departamentale (Artit, Folklorit, Etnologjisë), dhe në rang instituti.

U nënvizua fakti që antropologjia shqiptare bashkëkohore ndeshet me sfidat e saj, ndër të tjera, me studimin e një shoqërie me ndryshime të thella dhe të shpejta, që duke përfizuar serish një herë tjetër punën, Baumanit, e konkretisht Likuid Modernity antropologjisë shqiptare post-socialiste do t'i duhej të përballë njëherazi me modalitete të ndryshme të modernitetit dhe tradicioneve, që herë shfaqen vrullshëm si modernitete të lëngshme, e herë si të ngurta.

FILMAT

Fatmira Nikolli

KINEMAJA SHQIPTARE

Në Itali nga "Njeriu me top" te "Gjeneral Gramafoni"

Filmi "Gjeneral Gramafoni" i Viktor Gjikes (1978) u shfaq mbrëmë në orën 18:00 në Casa del Cinema në Villa Borghese, Romë, në çelje të Festivalit "ALBANIA, SI GIRA!". Për festivalet e filmit shqiptar në Romë kanë shkruar gazetaret kryesore italiane si "La Repubblica", "Trovaroma", "Corriere della Sera", "Left", "Avvenire", etj. Si një rrugëtim në kinematografinë tonë, ai është organizuar nga Cultural Pro, me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës dhe ambasadës shqiptare në Romë, në bashkëpunim me Arkivin Qendror Shtetëror i Filmit.

Në ditët në vijim shfaqen filmat "Letra ere", "Njeriu me top", "I dashur armik", "Koncert në vitin 1936", "Lindje Perëndim Lindje", "Amaneti", "Bota Cafe", "Lulëkuqet mbi mure".

Festivali vjen nga nevoja për të eksploruar marrëdhëniet italo-shqiptare të së kaluarës dhe të tashmes, për të kuptuar cilat janë aspektet më të zakonshme, të veçanta, të përkohshme dhe të përhershme të mënyrës në të cilën shqiptarët perceptojnë Italinë dhe italianët. Festivali është organizuar në mënyrë specifike për të rishikuar dhe kapërcyer paragjykimet dhe stereotipat që mbizotërojnë në diskursin publik mbi qëndrimet e shqiptarëve dhe italianëve me njëra-tjetrin, për të zbuluar një botë me marrëdhënie të shumfashita mes dy popujve.

FILMAT

Me regji të Viktor Gjikes e skenar të Vath Koresht "Gjeneral Gramafoni" vendoset në mesin e viteve 30 fillon penetrimi dhe parapërgatitja e pushtimit italian të vitit 1939. Halit Berati një klarnetist virtuoz dhe Parandili, flohen nga një sipërmarrës italian të inçizojnë në pllaka gramafoni meloditë e tyre, të cilat do të shiten së bashku me muzikën italiane të kohës së fashizmit. Gjatë kësaj kohe fillojnë grevat e punëtorëve të naftës, ku Halil Berati është punëtor.

Aktorë: Bujar Lako, Guljelmo Radoja, Kadri Roshi, Sulejman Pirtarka, Llambi Koçani, Reshat Arbana, Sheri Mita, Muhamet Sheri, Stavri Shkurti, Mimoza Topulli, Tinka Kurti, Dhimitër Orgocka, Adrian Rruga, Kastriot Azizaj, Sander Prosi, Shpëtim Shmili, Sotiraq Çili, Petra Xhillari, Piro Kita, Luftar Pajo, Margarita Xhepa, Ilir Erzeni, Marko Bitraku, Kiço Keri, Dhimitër Greku, Genc Hasani, Rifat Dajko, Lefter Buçka, Dhimitër Traçe, Raqi Jankulla, Abedin Hajro.

Me skenar e regji të Viktor Gjikes, "Njeriu me top", është ekranizim i romanit me të njëjtin titull të Dritëro Agolli. Mato Gruda, jeton në hasmëri me familjen e plakut Mere Fizi. Mato ka fshehur një top të cilin ëndërron ta përdorë kundër Mere Fizit dhe ka marrë në shtëpi si rob edhe një italian që e thërrret Agush dhe që i mëson përdorimin e topit. Kështu zbulohet e fshehta e një fshatari që lidhet me zor me luftën. Aktorë: Timo Fllora, Elida Cangonji, Stavri Shkurti, Drita Pellingu, Zef Bushati,

Kadri Roshi, Thimi Filipi, Birçe Hasko, Enea Zhegu, Sander Prosi, Piro Qiqi, Pandi Siku, Drini Hila, Petra Xhillari, Nikolla Llambri, Alfred Bualioti, Mehmet Bala, Thoma Basha.

Me regji të Dhimitër Anagnostit dhe skenar të tijin me Petra Xhillari, "Lulëkuqet mbi mure" ka në fokus jetimet e një strehe vorflore, që nën urdhrat e drejtorit dhe kujdestarit të tyre, pastrojnë çdo natë parullat që njerëzit kanë shkruar kundër fashizmit. Katër shokë të vegjël, Jaçe, Lelo, Bardhi, Tomi organizojnë rrëzimin e kujdestarit nëpër shkallë. Nga frika e presioneve të kujdestarit, Sulo i vogël përpiqet të kapërcëjë muret e jetimores dhe vritet nga patrulla. Aktorë: Timo Fllora, Agim Qirjaqi, Kadri Roshi, Alfred Kote, Liza Lasku, Anastas Kristofori, Luan Kerimi, Pavlina Mani, Enver Dauti, Strazimir Zajmi, Enea Zhegu, Artur Hoxholli, Krenar Arifi, Gjergj Pilika, Roland Ohri, Robert Xhuli.

Me regji të Saimir Kumbaros e skenar të Kiço Blushit, "Koncert në vitin 1936" ndjek një këngëtare e re, Donika, dhe një pianistë Eleini, që nisin një turne koncertesh në qytete të vegjël provinciale

Festivali i filmit shqiptar në Romë, për të tejkaluar paragjykimet



duke kaluar me pianon e tyre edhe nëpër fshatra. Dy artistet e reja takojnë shumë mikpritës midis të cilëve popullin e thjeshtë dhe autoritetet lokale që kërkojnë të duken oksidentale por që në thelb janë të konfrontuar me njëri-tjetrin. Aktorë: Manushaqe Qimami, Margarita Xhepa, Robert Ndrejka, Bep Shiroka, Gjon Karma, Roland Trebicka, Nikolla Llambri, Albert Verria, Ilija Shyti, Mirush Kabashi, Piro Qiqi, Enver Dauti, Birçe Hasko, Gezim

Kame, Hasan Fico, Muhamet Shehu, Gjon Kacagjeli, Aristotel Stefani.

Me skenar të Dhimitër e Gjergj Xhuvanit e regji të këtyrë të fundit, filmi "I dashur armik" i vendos ngjarjet në një familje të Shqipërisë së mesme gjatë Luftës II Botërore dhe përcillet mesazhi i tolerancës. Pas kapitullimit të Italisë, tregtari Harun fsheh në shtëpinë e tij, një ushtar italian, ndërkohë që aty ndod-

het i fshehur edhe një partizan i plagosur. Tregtari përpiqet të përfitojë nga kushtet e luftës. Rrethana e shpien të ndihmojë edhe një ballist e një ciftut dhe bashkëpunon në tregti me një oficer gjerman. Pas luftës tregtari i hedhin pranget si bashkëpunëtor me armikun. Aktorë: Luiza Xhuvani, Ndrim Xhepa, Peter Lohmeyer, Marko Bitraku, Helidon Fino, Birçe Hasko, Margarita Xhepa, Niko Kanxheri, Nina Petri, Rinaldo Roço, Agim Qirjaqi, Lefter Simoni, Anila Varfi.

Filmi "Lindje Perëndim Lindje" sërish nga familja Xhuvani ka në qendër Ilo Zoton, një trajner ciklizmi dikur vetë kampion i ciklizmit, por tashmë ka rreth 20 vjet që ka lënë sportin dhe punon biçikletaxhi. Ai caktohet trajner i një ekipi amator ciklistësh që nis et për turne në Francë por pasi ngecin në Itali marrin vesh se në Shqipëri është përmbysur regjimi dhe kështu u duhet të kthehen në atdhe me rrugë tokësore dhe me mjet udhëtimi biçikletat e tyre. Aktorë: Ndrim Xhepa, Ervin Belleri, Helidon Fino, Gentian Hazizi, Lulzim Zejza, Shkumbin Istrefi, Nela Lucic, Valina Mucolli, Oni Pustina, Denalda Teli.

BORSHI MIRËPRET FESTIVALIN "SOUTHOUTDOOR", PASHKËT FESTOHEN NË NJË ATSMOSFERË NDRYSHE

kuzhinë tipike shqiptare.

I njohur për potencialet agro-turistike, historinë, kalanë mbi kodër dhe ulishtet, sivist aktivitetet kryesore mbahen mes natës dhe detit, duke lënë shumë ngjarje edhe për Jalën e Porto-Palermos. Organizatorët kanë rezervuar shumë adrenalinë për pjesëmarrësit me disa aktivitete: Trekking, hiking, mountain bike, scuba diving, jeep safari, kayak, stand up paddle, paragliding, "Hot Air Ballon", "Trike Flying", "Gara Stand Up Paddling", "Sailing", "Paddleboard Yoga" si dhe "Individual Stand Up Paddling". Kordinatorja e projektit të jugut në GIZ që organizon festivalin, Dhurata Gazulli tha se festivalet zgjat 4 ditë, sepse datat përkojnë me festën e Pashkëve dhe shefi Sokol Prenga ka menduar që të gjithë pjesëmarrësit të përfsihen në festë duke ngjyrosur vezët e kuqe, ndërsa nuk do të mungojë as buka e pashkëve e lyer me vezë. Si çdo vit do të jenë panairi i produkteve lokale dhe artizanatit, ndërsa banorët e zonës do të ofrojnë një "minitreg" me ushqime të zonës do të zhvillohet ditën e diel, me rastin e festimeve të Pashkëve. Ndërsa Eraldo Rexho foli për mbrëmjet muzikore. "Nën tingujt e muzikës

latine dhe performimit të dyshes me të famshme në Shqipëri, nata e tretë e "South Outdoor" Festival do të jetë magjike. Vensora & Lindi do t'ju dhurojnë një mbrëmje për t'u mbajtur mend" tha ai duke kujtuar se do të ketë edhe balerinë që u mësojnë të pranishmëve të kërcejnë.

Ai shtoi se netët janë një maratonë më vete me performanca muzikore live ku artistët pjesëmarrës do të jenë, Alban Nimani, Urban Band, All in Band dhe grupi legjendar "Elita 5".

Drejtuesja e Programit "Zhvillimi i Qëndrueshëm i Zonave Rurale", financuar nga qeveria gjermane dhe implementuar nga GIZ, Anke Petersen tha se: "Qëllimi i këtij festivali është krijimi i një modeli të qëndrueshëm, i cili do të bëjë të mundur zgjatjen e sezonit turistik, duke nxjerrë në pah atraksionet e shumta të zonës, të cilat mund të shijohen më së miri edhe përtej sezonit veror". Ajo tha se ky qëllim do të përmbushet duke sjellë bashkë aktorë të niveleve të ndryshme, që nga bizneset private e deri tek institucionet qe-

veritare. "Festivali është një produkt i integruar, ku të gjithë punojnë për të ndërthurur dhe nxjerrë në pah vlerat kulturore, historike e natyrore që ofron kjo zonë, duke lidhur detin me malin dhe duke promovuar asetet e fshehtrave të ndodhura në brendësi të territorit. Synimi kryesor nuk është vetëm promovimi i një hhati të vetëm, siç në këtë rast është Borshi, por edhe i fshatrave të tjerë, ku, gjithashtu, do të zhvillohen aktivitetet të lidhura me festivalin"-shtoi ajo. Kujtojmë se edicioni i parë i "South Outdoor" u zhvillua në Pilur, ku ishin të pranishëm rreth 3000 pjesëmarrës, 600 prej të cilëve ishin vetëm për aktivitetet sportive. Në edicionin e dytë, të organizuar në fshatin bregdetar të Vunoit, numri i vizitorëve u dyfishua në 6000 vetë. Aktiviteti mbështetet nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Turizmit dhe Bashkia Himarë. Edhe këtë vit si çdo edicion i kaluar i festivalit, pritet të ketë një numër të madh pjesëmarrësish dhe shumë surpriza të organizuara posaçërisht për ta.f.a.ni.

Opinion i Ditës

BE, BRI dhe Ballkani

Nga Jorgji Kote

(vijon nga faqja 1)

... dhe modernizimin e rrjetëve hekurudhore dhe detare të njohura mbi 2000 vjet më parë si "Rruga e mëndafshit". E shpallur nga Presidenti kinez Xi Jinping në fjalimin e tij në Universitetin e Kazakistanit në vitin 2013, BRI u zyrtarizua përfundimisht në Kongresin e XIX të PKK në tetor 2017, si strategjia gjeopolitike për vendosjen e hegemonisë globale kineze në "Shekullin e Pacifikut" në Evropë, Afrikë dhe Azi.

Ndryshe nga emërtimi i kufizuar në njëjës, kjo nisimë përbëhet nga ky komponentë themelorë: "Brezi i mëndafshit ekonomik i korridoreve tokësore/hekurudhore" dhe "Rrugët e reja detare të mëndafshit të shekullit XXI". Kështu, ajo shkon shumë e shumë më larg, me projekte e programe gjigante ekonomike, tregtare, energjetike, telekomunikacioni, ndërlydhje, kulturore etj., që në vitin 2017 përfshijnë 100 shtete me 4.5 miliardë banorë, të cilat japin rreth 65 për qind të GDP-së botërore.

Javën e kaluar tërhiqjen vëmendjen katër veprimtari madhore në Evropë, të cilat tregojnë se tani edhe vetë BE-ja me vendet anëtare po "kërcënohen", madje ndonjë ka filluar të "dorëzohet" ndaj "mëndafshit" kinez, pavarësisht nga demarshet politike dhe diplomatike të deritanishme. Një vit më parë, të 27 ambasadorët e BE-së në Kinë kërkuan me një letër publike kujdes dhe distancim lidhur me BRI, i konsideruar dhe si "Kali i Trojës Kineze". Tri javë më parë, Komisioni Evropian miratoi dokumentin përkatës strategjik të bashkëpunimit, ku nënvizohet se, "Kina për BE-në nuk është më vetëm partner tregtar, por rival sistem, një vend që po promovon një model të ri alternative qeverisjeje".

Pavarësisht nga sa sipër, shumica e ekspertëve pohojnë se ashtu si edhe për rrjetin ndërlydhës G-5 "Huawei", BE nuk ka dalë ende me qëndrime të njehsuara e të besueshme, me qëllim që të jetë në gjendje të kanalizojë ambicjet e saj ekonomike dhe diplomatike, mbi bazën e rregullave të multilaterizimit dhe nga ana tjetër të bëjë përpjekje të bashkojë vendet anëtare përballë shtimit të "oreksit" kinez.

Këto ide dhe kërkesat për reciprocitet, transparencë, respektim të rregullave të lojës, BE-ja ia shprehu presidentit kinez, Xi Jinping, në Paris më 27 mars, në Samitin katërpalësh BE-Kinë, Francë dhe Gjermani. Nga ana e tij, presidenti Xi deklaroi se, "një Evropë e bashkuar në lulëzim ekonomik përputhet me vizionin e Kinës për një botë multipolare dhe se 'Rruga e Mëndafshit' synon të realizojë një bashkëpunim të harmonishëm të të gjithë njerëzimit, ndaj Kina mbështet integrimin, zhvillimin dhe unitetin evropian.

Kështu, BRI po bëhet "prova e



zjarrit" për BE-në dhe qëndrimet e saj konkrete politike. Më interesante dhe intriguese paraqitet situata në vendet anëtare. Kështu, me ftesë të presidentit francez, Macron, më 25-26 mars zhvilloi një vizitë shtetërore në Paris presidenti kinez, Xi Jinping, i cili u prit me pompë të madhe. Edhe pse në prag të bisedimeve me të, Macron deklaroi se, "bashkëpunimi me Kinën duhet bërë mbi baza të qarta, ekzgjente dhe ambicioze". Mirëpo, ndryshe nga Franca, që kërkoi kryesisht vetëm bashkëpunim në fushën e klimës, Xi Jinping kërkoi bashkëpunim global për të gjitha çështjet. Vërtet që me Francën zyrtarisht nuk u bë ndonjë marrëveshje ose kontratë për BRI-në, por gjithsesi u ra dakord që në vitin 2021 në Paris të çelët ekspozita e madhe mbi rrugët e mëndafshit që përshkoi Marco Polo në fund të viteve 1200, madje përpara se të hapet në Pekin. Veç kësaj, u nënshkrua kontrata gjigante për shitjen e 300 avionëve "Airbus" me vlerë prej 35 miliardë euro, etj. Në pozitë më të vështirë ndodhen Greqia, Spanja, Portugalia, Polonia, Hungaria, të cilat kanë shumë nevojë për zhvillime dhe investime në të gjitha fushat, ku Kina është tejet aktive. Kjo, jo vetëm për të përmirësuar treguesit social-ekonomikë, por edhe që të mbeten aktorë të rëndësishëm e të besueshëm rajonalë.

Gjithsesi, vëmendjen ndërkombe tërhiqti Italia, e cila u bë vendi i parë anëtar i BE-së dhe i G-7 që e përqafoi zyrtarisht BRI-në. Më 22 mars u nënshkrua në

Romë, në prani të presidentit kinez Xi Jinping dhe kryeministrit italian De Conte, Memorandum i Mirëkuptimit ndërmjet dy qeverive mbi bashkëpunimin dypalësh në këtë nisimë. Mbi këtë bazë dhe të 10 kontratave gjigante me vlerë rreth 20 miliardë euro, Kina do të bëjë investime të mëdha e të shumta në energjetikën, infrastrukturën, telekomunikacionet italiane, modernizimin e aeroportit të Romës, të porteve në Xhenova dhe Trieste, eksporteve italiane, etj. Reagimet nga Komisioni Evropian nuk munguan, por ato ishin të matura dhe të kujdesshme tani, vetëm dy muaj nga zgjedhjet e reja evropiane.

Në pozitë më të mira mbrojtëse është Gjermania, por edhe aty gjërat po lëvizin, edhe pse në formatin jozyrtar. Kështu, më 29 mars, në qytetin-port Bremen u zhvillua ceremonia zyrtare e inaugurimit të Shoqatës Federale Gjermane të Nismës për "Rrugën e Mëndafshit" (Bundesverband Deutsche Seidenstrasse Initiative (BVDSI) pas dy vitesh veprimtarie. BVDSI synon të nxisë "vëmendjen e politikës së jashtme gjermane drejt aspekteve pozitive të nismës për ndërtimin e rrugëve të mëndafshit". Ajo që bëjnë përshlyetje është apeli i fortë i bashkëpresidentëve të saj, Hans Von Helldorff dhe Nadine Hellmoe ndaj ministrit Federal të Ekonomisë, Peter Altmaier dhe atij të Jashtëm, Haiko Maas. Ata kërkojnë që të hiqet dorë sa më shpejt nga politika e bllokadës ndaj "Rrugës së Mëndafshit". Madje, shkojnë më tej duke kërkuar të

hiqet dorë nga politika e njëanshme gjermane e kushtëzimit të marrëdhënieve me Kinën me vlerat/standartet demokratike, sipas tyre, kjo politikë nuk ka sjellë asnjë rezultat apo ndikim konkret as në Kinë e as në Rusi. Sipas BVDSI, në kushtet kur dhe ekonomia gjermane po tregon shenja dobësie dhe rënie si pasojë dhe e luftës tregtare me SHBA, "këmbëngulja për ta kushtëzuar bashkëpunimin ekonomik me Kinën me mbrojtjen e vlerave dhe të drejtave të njeriut ka rezultuar tërësisht kundraproduktive".

Mirëpo, pas kritikave në Bundestag mbi këtë shoqatë, qeveria gjermane reagoi duke mos dërguar përfaqësuesit e saj në ceremoninë e inaugurimit, gjithashtu ajo urdhëroi drejtuesit e BVDSI-së që të hiqnin nga 'web'-i i tyre përshëndetjen e sekretarit Parlamentar të Shtetit në Ministrinë Federale të Transportit dhe Infrastrukturës Dixhitale, Enak Ferlemann i CDU-së, sepse ajo i përkiste vitit të kaluar. Aty ai shprehte "mbështetjen për qëllimin e jashtëzakonshëm të BVDSI, jo vetëm nga këndvështrimi ekonomik, por edhe nga sfondi i shkëmbimeve kulturore, që ofrojnë rrugët e mëndafshit". Kjo kthesë e qeverisë gjermane shpërgohet me zhvillimet e lartpërmendura, por edhe me faktin se ndryshe nga SHBA-të e ndonjë vend tjetër evropian, Gjermania është shprehur e hapur ndaj depërtimit të rrjetit celular G-5 në Gjermani. Po ashtu, ajo u ka injoruar kritikë e partnerëve lidhur me

ndërtimin e rrjetit gazsjellës rus Nord Stream II, kështu që mbështetja për BRI do ta kompromentonte, shtonte problemet për politikën e saj të jashtme.

Këto dhe zhvillime të tjera të pritshme dëshmojnë se BE-ja dhe vendet anëtare po ndërgjegjësohen se këto marrëdhënie interesash strategjike po marrin përparësi të madhe, çka do të thotë se ato mund të bëjnë edhe "një sy qorr e një vesh shurdh" lidhur me shqetësimet në Kinë dhe në vende të tjera të mëdha mbi të drejtat e njeriut dhe standardeve demokratike ose do të shprehën "sa për të larë gojën". Sepse tanimë institucionet e BE-së dhe vendet anëtare po e humbasin dora-dorës fuqinë e tyre të "kulaçit dhe kërbatit". Këtë tendencë negative e thekson dhe fakti se tani dhe të drejtat/liritë themelore të njeriut nuk mund të respektohen pa zhvillim dhe begati ekonomike, pa luftuar papunësinë kronike dhe paparazinë social-ekonomike, mirëpo këto janë të pamundura, pa intensifikuar bashkëpunimin ekonomik dhe investimet me Kinën, Rusinë, Turqinë, Brazilin, etj.

Këto zhvillime lidhen padyshim edhe me Ballkanin Perëndimor. Jo vetëm se Rrugët e Mëndafshit do të shtrihen deri në Portin e Pireut, por edhe sepse ne jemi pjesë e nismës politike/ekonomike kineze 16+1. Shqetësimi i parë është ai i shtimit të përmirësimit të kapaciteteve tona teknike dhe financiare për thithjen dhe zbatimin e projekteve kineze. Sepse shkëmbimet dhe marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare me Kinën do vijojnë dhe nuk kemi pse të fshihemi si struci.

Siç u pa më lart, Kina me synimet dhe projektet e saj globale i shtohet listës së shqetësimeve madhore strategjike për BE-në, krahas Brexit, krisjeve me SHBA-të, përçarjet brenda saj, përshkallëzimit të populizmit dhe ekstremizmit, krizave financiare, etj. Në këto kushte, BE-ja dhe vendet anëtare janë të supernërgarkuara me hallet dhe telashet e veta serioze. Gjithçka tjetër, përfshi edhe rajonin e Ballkanit Perëndimor me problematikat e nxehta dhe zgjerimin drejt tij janë "too much" për t'u përtypur nga BE-në. Lodhjes dhe alergjisë nga ky zgjerim u janë shtuar problemet dhe dëshimet e klasës politike në vendet tona. Për pasojë, zgjedhësit në vendet e BE-së dhe ato kandidatë po e shohin qartë se anëtarësimi në BE nuk përbën më ilaçin magjik të zgjidhjes së këtyre problemeve, siç mendohej më parë. Veç kësaj, Franca, Holanda, Danimarka po shprehen hapur se përpara zgjerimit kërkohet thellimi i reformave brenda BE-së. Kjo tezë po fiton më shumë terren edhe në vende të tjera me peshë. Për pasojë, ka ardhur koha që klasat politike në rajonin tonë të mos presin më ndërmjetësim klasik e ca më pak zgjidhje nga faktori ndërkombehtar, por të fillojnë e japin kontributet e veta demokratike, duke marrë në dorë fatin dhe të ardhmen e tyre.

Intervista e Ditës

Emigracion dhe popullsia në rënie, quo vadis Shqipëri?!

Nga Isilda Mara

(vijon nga faqja 1)

... vendet e Europës Lindore e Juglindore dhe pasojat e emigrimit masiv për tregun e punës. Fenomeni i largimit të fuqisë punëtore prek edhe Shqipërinë, Kosovën e rajonin. Ekspertja e këtij instituti, Isilda Mara, flet për pasojat e emigrimit për Shqipërinë.

"Deutsche Welle": Raporti i Institutit të Vjenës për Studimet e Ekonomisë Botërore (WIIW) hedh dritë mbi një problem të rëndësishëm, mungesën e fuqisë punëtore në vendet e rajonit evropiano-lindor. Sa akut është ky problem për Shqipërinë?


Isilda Mara: Po, edhe për Shqipërinë është problem. Gjatë dekadës së fundit, 2011-2017, Shqipëria ka pasur mesatarisht një rritje natyrore të popullsisë me një plus rreth 4.2% dhe një normë mesatare të emigracionit neto (diferenca midis atyre që emigrojnë ose largohen nga vendi dhe atyre që imigrojnë në Shqipëri) me një minus 6%, pra duke rezultuar në një reduktim të popullsisë me 1.8%. Gjatë 4 viteve të fundit shtesa natyrore e popullsisë është përgjysmuar. Sigurisht rënia e fertilitetit në nivelin 1.7 (nr. i lindjeve për grua) është një faktor që shpjegon rënien. Megjithatë, tashmë jo vetëm faktori emigracion, por edhe shtesa natyrore e popullsisë po ndikojnë njëkohësisht në rënien dhe plakjen e popullsisë.

Eksperti i institutit vjenez që punoi për studimin, zoti Richard Grieveson tha, se kjo nuk ka ndodhur kurrë më parë në kohë paqeje në rajonin evropiano-juglindor e lindor, kaq dramatikisht është gjendja?

Isilda Mara: Gjendja është dramatikë në sensin se jo vetëm Shqipëria, por edhe vendet e tjera të Europës Lindore tashmë kanë humbur një pjesë të mirë të forcës punëtore dhe aktive dhe nuk e kanë më atë bonus apo dividend demografik, që kanë pasur të paktën tri dekada më parë. Këto vende, përfshi edhe Shqipërinë, për më tepër kanë humbur jo vetëm të rinjtë, por edhe më të kualifikuarit. Me një normë fertiliteti që ka konvergjuar në nivelin e 1.57 - krahasuar ajo e vendeve të Europës Perëndimore - EU-1.5 - është e vështirë të imagjinojë sesi këto vende mund të rikuperojnë apo gjejnë një zgjidhje afatshkurtër, por edhe afatgjatë për të përmbysur trendin negativ të rritjes së popullsisë.

A ka të dhëna se në cilët sektorë shfaqet më shumë mungesa e fuqisë punëtore?

Isilda Mara: Po, nga burime të ndryshme informacioni ka të dhëna se jo vetëm sektorët që kërkojnë punëtorë të kualifikuar



po përballen me vështirësi në gjetjen e stafit dhe plotësimin e vakancave, por edhe sektorë të tjerë janë duke u përballur me sfida të ngjashme. Në Shqipëri, sektori më i prekur është ai i mjekëve dhe infermierëve. Edhe Sllovakia ka vështirësi në gjetjen e infermierëve, mjekëve, por edhe profesionistëve si inxhinierë, përpunues të 'database', punonjës të montimit të pajisjeve dhe makinerive, por edhe punonjës të shitjeve dhe shërbimeve.

CILAT JANË PASOJAT E KËTIJ FENOMENI PËR VENDET E RAJONIT?

Isilda Mara: Pasoja janë sigurisht së pari demografike: plakje dhe tkurrje e popullsisë. Pra, mungesa e kapitalit human për shkak se të rinjtë dhe ata që janë të kualifikuar kanë emigruar dhe vazhdojnë të emigrojnë. Pajoja tjetër është në zhvillim, për shkak se rritja ekonomike mund të ndikohet negativisht, nëse sektorët në zhvillim dhe ekspansion përballen me sfida e gjetjes së krahut të punës dhe kualifi-

fikimet dhe aftësitë e nevojshme. **ÇFARË DUHET TË BËJË POLITIKA E KËTYRE VENDEVE KONKRETISHT PËR TA ZBUTUR KËTË PROBLEMI?**

Isilda Mara: Sigurisht duhen ndjekur politika, të cilat mund të zbusin rritjen negative të popullsisë, rritja e fertilitetit po ashtu, këta janë faktorë që e tregojnë efektin në terma afatgjatë. Në ato afatshkurtër termi imigracion nga vendet e tjera mund të jetë një opsion i shpejtë, megjithatë duke pasur parasysh sfida të migracionit me të cilat po përballen BE-ja, duhet theksuar se migracioni mbetet një alternativë shumë e diskutueshme.

PO KONKRETISHT SHQIPËRIA?

Isilda Mara: Nëse do të merrja parasysh Shqipërinë, është shumë e rëndësishme që të zbutet emigracioni duke afruar perspektiva me të mira për të ndërtuar një të ardhme në Shqipëri. Faktor tjetër që duhet të merret në konsideratë është edhe diaspora,

përfshirja e saj me aktive për thithjen e investimeve dhe 'know-how'. Kjo duhet parë me përparësi dhe në këtë drejtim duhen ndërmarrë hapa. Gjithashtu, remitancat - aspekti pozitiv i emigracionit të lartë - nuk duhet thjesht të shkojnë për konsum, por të kanalizohen në investime dhe gjenerim vendesh pune.

Studimi i institutit vjenez përmend digitalizimin dhe automatizimin e punës, si një mundësi për t'u përballur me mungesën e fuqisë punëtore. Sa mund të ndihmojë ai, kur këto vende janë ende shumë pas niveleve evropiane?

Isilda Mara: Dixhitalizimi sigurisht është një mundësi e mirë, megjithatë digitalizimi është një element komplementar. Ai është për ato profesione që kërkojnë "hard skills" dhe mund të ndihmojë pak për ato profesione, të cilat kërkojnë "soft skills". Vendeve të Europës lindore u mbetet ende shumë për të bërë në këtë drejtim.

HOROSKOPI

DASHI

Të lindurit e kësaj shenje mund të përjetojnë disa momente të pakëndshme sot. Ndoshta mund të përfshihen në një konflikt teksa udhëtoni me transport publik ose mund të merrni kritika nga shefi/shefja juaj.

DEMI

Sot do të jeni të rrethuar nga pozitiviteti. Do të keni çdo shans për të shënuar sukses në çdo fushë të jetës suaj. Ndërsa sa i përket marrëdhënies suaj në çift, duhet të bëni përpjekje maksimale për të arritur atë çfarë dëshironi.

BINJAKET

Disa Binjakë do të bëjnë marrëveshje me ndërgjegjen. Mund t'ju ndodhë një situatë paksa pikante në jetën personale. Ka gjasë të harroni moralin në një moment të caktuar, kur bëhet fjalë për suksesin në karrierë.

GAFORJA

Disa Gaforre mund të lodhen nga një person, i cili ju acaron vazhdimisht. Tregohuni të duruar, mbi të gjitha nëse bëhet fjalë për dikë që ka ndikim në jetën tuaj. Do të kaloni një mbrëmje të qetë nën praninë e partnerit/partneres suaj.

LUANI

Do të jeni të mbushur plot energji dhe kjo do t'ju ndihmojë që të zgjidhni një sërë problemesh pa u lodhur. Përpuni që pjesën tjetër të ditës t'ia kushtoni vetes dhe do të ishte mirë të mendoni për mënyrat me të mira për t'u relaksuar.

VIRGJERESHA

Përpuni të kontrolloni çdo fjalë këtë të premte, pasi një fjalë e gabuar mund të çojë drejt një konflikti, i cili mund të ndikojë në të ardhmen tuaj. Sot do të relaksoheni vetëm kur të jeni nën praninë e të afërmeve. Shmangni bisedat delikate apo pyetjet provokuese.

PESHORJA

Mos hiqni dorë nga eksperimentet në dashuri, por pa shkelur normat e moralit. Qëndroni me këmbë në tokë dhe mos i diskutoni të gjitha idetë tuaja. Parashikohet një mbrëmje mjaft romantike, nën praninë e personit tuaj të zemrës.

AKREPI

Disa Akrepë do të shqetësohen lehtë sot. Kjo mund të vijë për shkak të gjendjes emocionale dhe konfuzionit me mendimet tuaja. Mund ta largoni këtë gjendje duke dalë në natyrë, duke kaluar kohën me fëmijët ose duke menduar pozitivisht.

SHIGJETARI

Disa Shigjetarë më 5 prill do të jenë plot shpresa. Ka gjasë të fitoni një vend mjaft të mirë pune ose të ngriheni në detyrë. Mund të përjetoni një situatë të tensionuar në jetën personale. Një konflikt i vjetër në familje mund të përkallëzohet.

BRICJAPI

Rekomandohet ta shpenzoni në mënyrë sa më produktive këtë të premte. Lini pas gjërës që nuk japin rezultate të menjëhershme. Do t'ju duhet t'i përgjigjeni një çështje urgjente dhe të ndërmerrni vendime të rëndësishme.

UJORI

Disa Ujorë do të kenë sukses në marrëdhëniet profesionale. Mund të merrni shpërbim pas përfundimit të një projekti ose t'ju japin një pozicion më prestigjioz. Ngjarjet pozitive në sferën e ndjenjave janë gjithashtu të mundura.

PESHQIT

Peshqit nuk janë imunë ndaj ndryshimeve të papritura. Ato mund të lidhen me fatin profesional ose me fatin e një biznesi personal. Mos u përfshini nga paniku nëse humbisni kontrollin e asaj çfarë po ndodh rreth juaj.

RENDITJA E FIFA-S



Ditën e djeshme, FIFA ka publikuar zyrtarisht renditjen më të fundit për sa u përket Kombëtareve. Në këtë listë, Kombëtarja e Shqipërisë ka rënë me një pozicion, ndërsa duket se ka ndikuar humbja e fundit në kualifikueset e Europianit 2020 ndaj Turqisë, e cila solli edhe shkarkimin e trajnerit Kristian Panuçi. Shqipëria tashmë renditet në pozicionin e 62 me 1368 pikë të

Shqipëria humbet një vend, Kosova ngjitet tri pozicione

grumbulluara. Ndërkohë që triumfi ndaj Andorrës nuk ka rezultuar shumë efikas për sa u përket pikëve të llogaritura nga institucioni i FIFA-s. Sakaq, bie në sy që para Kombëtares kuqezi në këtë listë renditen ekipet e Honduras apo Burkian Faso.

Ndërkaq, vazhdon rritja e përfaqësueses së Kosovës, të cilët renditen në vendin e 127, me 1124 pikë. "Dardanët" kanë përfituar 3 vende, ndërsa rezultatet pozitive në kohët e fundit, duke përfshirë barazimin me Danimarkën në miqë-

sore, por edhe barazimi me Bullgari në kualifikueset e Europianit janë reflektuar edhe në renditjen e fundit të FIFA-s. Sa i përket kryes së listës, nuk kanë ndryshuar 3 vendet kryesuese, me vendin e parë që mbahet nga Belgjika dhe pas saj, Franca me Brazilin. Jashtë 10 vendeve të para renditen Argentina (11), Gjermania (13), Italia (17).

Sot është menaxheri i tij, por Lala e sheh këtë detyrë si të pjesshme: Dua të ndihmoj lojtarët



Jeton Selimi

Altin Lala mban statusin e legendës si në futbollin shqiptar, ashtu edhe në atë gjerman, pasi për shumë vite ish-mesfushori ka veshur fanellën kuqezi të Shqipërisë dhe atë të Hanoverit në Bundesligë, duke mbajtur te të dyja edhe shiritin e kapitenit. Por, ish-mesfushori tashmë ka filluar të tërheqë vëmendjen përsëri në Gjermani me zbulimin e madh që ka bërë në atë që e cilëson vetë si profesion "part-time", si menaxher lojtarësh. Bëhet fjalë për Milot Rashicën, i cili nën mbikëqyrjen e Lalës ka arritur të bëhet gjithnjë e më shumë një emër i rëndësishëm në futbollin evropian dhe këtë po e kuptojnë të gjithë të Verder Bremen, ku golat dhe asistet e futbollistit të përfaqësueses së Kosovës kanë kthyer përsëri buzëqeshjen te një tifozeri, e cila në sezonet e kaluara ishte mësuar me shumë dëshitime. "Unë e dija që Miloti mund të arrinte shumë më afërsisht që ka, por ai mund të bëjë edhe më

Altin Lala rrëfëhet për Rashicën: Do të bëjë më shumë se kaq

Ish-kapiteni kuqezi mbështet talentin vushtrias



shumë", tregoi menaxheri i futbollistit për "Deich-Stuben", ku kaloi edhe një herë etapat e karrierës së Rashicës dhe si e kishte pikasur djaloshin e talentu-

ar. Ai ka treguar se fillimisht e kishte parë në TV, në një ndeshje mes Kosovës dhe Gërmanisë U21, kur Rashica ishte vetëm 16-vjeçar. "I thashë djalit tim, shihe me vëmend-

je këtë futbollist, është me të vërtetë i mirë". Herën e dytë që e pa, ishte një vit e gjysmë më vonë, kur Lala ishte i pranishëm në stadium dhe po kërkonte lojtarë për Sh-

qipërinë U19. "Ai ishte momenti ku kontaktova me të, edhe babai i tij ishte aty". Aty lindi edhe plani. "Do ta mbështes këtë djalë në rrugëtimin e tij", tregoi Lala. Ai ishte munduar ta dërgonte te Hanover, por Rashica ishte i pafat. "Organizuan një provë, por Miloti pësoi dëmtim të ligamentit". Edhe për riaftësimin e tij mendoi Lala, i cili e mori në shtëpi dhe Rashica jetoi me të për thujt një vit, duke qëndruar me periudha tremujore në Hanover para se të kthehej në Kosovë. "Për shkak të statusit të rezidencës, ai nuk u lejua të qëndronte në Gjermani më shumë se 90 ditë radhazi", shpjegoi Lala peripecitë e asaj periudhe. Që atëherë filloi puna për Rashicën, i cili u transferua te Viteshe, pas sugjerimit të Lalës, i cili p potencialin e

futbollistit dhe iu përkushtua karrierës së djaloshit, të cilin tashmë ka arritur ta bëjë një prej emrave më të njohur në Bundesligë, edhe pse nuk e cilëson si profesion kryesor atë të menaxherit. "Unë e bëj punën e menaxherit vetëm pjesërisht. Thjesht dua të ndihmoj njerëz të talentuar", tregoi Lala. Për momentin, menaxheri Lala nuk e sheh Rashicën duke bërë një tjetër lëvizje të shpejtë në karrierë. "Jo, nuk është një çështje për diskutim për ne. Nuk ka asgjë. Miloti ka një kontratë deri në vitin 2022. Dhe vetëm prej tre muajsh po luan shumë mirë me Verderin. Jemi shumë të qetë dhe duam t'i bëjmë hapat me radhë, garantoi ai, duke larguar për momentin pretendentët që janë interesuar për talentin kosovar.

POST-KUPA

Lorenc Trashi sqaron "sherrin" me Ruçin

Partizani u mund nga Luftëtari dhe u eliminua nga Kupa e Shqipërisë, ndërsa u hamendësua që Lorenc Trashi ka pasur një moment tensioni me portierin elbasanas të Luftëtarit, Shkëlzen Ruçin, çka solli dhe irritimin e tifozërisë vendëse. Por në një postim në "Instagram", Trashi hedh poshtë këta zëra dhe kërkoi të sqarohet gjithçka me variantin e tij të situatës. "Për të sqaruar çdo gjë që është shkuar, Trashi me Ruçin janë shumë miq. Kur ka mbaruar pjesa e parë, jam afruar te tifozët, sepse një nga familjarët e mi ndodhej tek ajo pjesë ku disa tifozë filluan të ofendonin dhe për të mos pasur përplasje, doja t'i thosha që të largohet nga ajo pjesë e tribunës. Kaq është e gjitha, por nga jashtë duket sikur u konfliktova me tifozët, përkundrazi i respektoj ata", shkruhej në postimin e Trashit.



"Sky Sport" lëshon 'bombën'

Luçiano Spaleti i ka orët e numëruara tek Interi

Duket e pabesueshme, por gazetarja e "Sky Sport", Marianxhela Pira, ka raportuar për televizionin sportiv se Luçiano Spaleti i ka orët e numëruara tek Interi. Sipas gazetares së gjigantit të informacionit sportiv, situata ka ardhur pas përplasjeve të vazhdueshme të administratorit të deleguar të Interit, Xhuzepë Marotës, dhe teknikut toskan. "Në këtë moment marrëdhënia mes tyre është inekzistente, Marota dhe Spaleti janë thujtë të huaj për njëri-tjetrin. Spaleti jo vetëm që nuk bën asgjë nga ato që i kërkoi Marota, por del në televizione dhe bën të kundërtën. Është me fat që nuk largohet që sot", shkruan Pira, që më pas vijon: "Pyeta burimin tim në lidhje me Konten dhe nuk më mohoi asgjë. Përgjigja e tij ishte 'Interi mbi të gjitha'. Interi është në vendin e tretë në kampionat dhe fitorja me Xhenoa ka sjellë qetësi, mbi të gjitha edhe për shkak të aktivizimit të Mauro Ikkardit, i cili u rikthye te goli.


Në sulm për argjentinasin

Solskajer i fiksuar, kërkon Dibalën te Junajtidi

Paolo Dibala nuk po luan vitin e tij më të mirë te Juventus. Pas një sezoni prej protagonistit kampionatit e shkuar, argjentinasi po vuan shumë të gjëje hapësirë në formacionin titullar që pas ardhjes së Kristiano Ronaldos, me trajnerin Alegri, që është më i predispozuar të luajë me Mario Manxukin në krah të portugezit, me Dibalën që luan shumë larg zonës së portës. Parë këtë situatë, Manchester Junajtid kërkoi t'i plotësojë dëshirën teknikut të tij, Ole Gunar Solkskajer, me norvegjezin që e vlerëson shumë Dibalën dhe do të dëshironte ta kishte në skuadër sezonin e ardhshëm. Por, Juventus nuk e lë të lirë argjentinasin pa 120 milionë euro. Gjithsesi, më parë duhet kuptuar se çfarë do të ndodhë me Alegri në fund të sezonit.



Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Hari spiune.
4. Janë toksike.
9. Gjysmë arrest.
10. Janë vende pa ne.
13. Johnny i Donnie Brasco.
15. Priten nga meridianë.
18. Me të nxjerrin një letër.
20. U verbua nga Askushi.
21. Një britmë në arenë.
22. Shkrimtari i J'accuse.
24. Si moral.
25. Nota e diapazonit.
26. Me dies në një liturgji.
27. Një mund të jetë edhe veprimi.
28. Eshhtë e re pas Krishtit.
29. Inicialet e Bergman aktore.

30. Ai i trëndafilut është i Umberto Eco-s.

32. Fise pa fe.
33. Një provë zjarri.
34. Eshhtë mjeshtri me... baketë.
37. Digjen po nuk u zbuluan.
39. Iglitë Lazio.
41. Kush del... mbështet.
42. Mund të jetë unik.
46. Ngrihen për atentate.
47. Janë fjetore në kazerma.
48. Altini mesfushor.

VERTIKAL

1. Fillojnë matanë.
2. Një Hans artist dadaist.
3. Eshhtë mjet rrethanor lundrimi.
5. Eshhtë ënjtje.
6. Lumi i Elizit.
7. Fillojnë mpirjen.
8. Eshhtë e gjithë Hëna.
10. Eshhtë qetësues për neurozat.
11. Taylor aktore.
12. Daniel i Robinson Crusoe.
14. Kështu janë skenat që mallëngjejnë.

16. Eshhtë pjesë në skenë.
17. Lëvizje Ekologjike Lokale.
19. Përshkohej nga Leti.
22. Eshhtë muzika më e... kollajtë.
23. Grazia Cucinotta aktore.
24. Veriu pa ekstreme.
27. Janë tre në tricikël.
30. Scola, regjisor italian.
31. Kufizojnë një metër.
34. Mbahet me inat.
35. Mbyllin kurse.
36. Ka një shpejtësi fantastike.
38. Laik kur s'është ai.
40. Një liqen i kripur.
43. Një mund të jetë fetar.
44. Eshhtë lloj papagalli.
45. Në hyrje të sallës.
46. Priten të skaje.

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL

1. Janë lokale me kubete.
9. Me të nxjerrin në tapë.
11. Polanski regjisor.
12. Qeni i famshëm i Odiseut.
15. Mbeten në fund.
16. Gabon në ekstreme.
18. Rreh në kufij.
19. Eshhtë vepër për një... vepër.
23. Janë udhëtime për në një vend të shenjtë.
25. Dinë shumë gjuhë.
26. Një mendim.
27. Famëkeqi Capone.
28. Kush i kthen... të braktis.
29. Kisha pa zë.
30. I fejuari i kukullës Barbie.
32. Ritet pa re.


33. Një brinjë në skuadër.
35. Emri i Zola.
37. Eshhtë mosha e të miturit.
40. Një dispozitiv kohe.
41. Janë strehë për barinj.
42. Fillojnë aksionin.
43. Eshhtë ai që nuk qesh.
45. Të parat në ambient.
46. Gjysmë teorie.
47. Një binar.
48. Djeg kur bie.

VERTIKAL


1. Barrymore aktore.
2. Tiriac që qe tenist.
3. Ekstreme në studim.
4. Eshhtë kleri me papën.
5. Ndezur në aparaturë.
6. Kaluar në krye.
7. Janë racë e pastër.
8. Një treg pa re.
10. Duhet fiutur me djersë.
13. Një drithe për sake.
14. Lëvizin pasi mendohen shumë.
16. Janë sfera për bingo.
17. Eshhtë më pak se nxehtësi.
19. Gibson aktor.
20. Tregtonin skilevër dikur.
21. Mund të jenë fetare të tilla.
22. Kush nuk ka... nuk i ecën.
23. Një sherr në shtyp.
24. Një lidhëz.
25. Mund të jenë cigaresh.
29. Mund të bëjë zoom.
31. Ndërmarrje Industriale Mirditë.
33. Pak konkrete.
34. Eshhtë i mirë me shokë shumë.
36. Artikull për shumë francezë.
38. Kanto kur nuk... ka.
39. Muzika me jam session.
44. Mbyllin një sherr.
45. të fundit në sirtar.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

								9
	3		6	1				4
	7							5
6	8				2			9
	4			3				8
2					9			7
					6			1
	6	3					8	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

5	6	4	1	3	9	2	8	7
7	1	3	2	6	8	9	4	5
8	9	2	5	4	7	3	6	1
4	8	7	3	2	5	1	9	6
6	2	5	9	7	1	4	3	8
9	3	1	4	8	6	5	7	2
3	4	8	6	1	2	7	5	9
1	5	6	7	9	3	8	2	4
2	7	9	8	5	4	6	1	3

Argëtim filozofik

- Kur bëni një zgjedhje, mos mendoni nëse kjo është e drejtë apo e gabuar ... Mendo të jetë vetëm ajo që me të vërtetë ti dëshiron!!!

- Ata që munden, bëjnë. Ata që nuk munden, gjykojnë.

- Duhet një minutë për të parë një person të veçantë, një orë për ta vlerësuar, një ditë për ta dashur-uar, një fjalë për ta lënduar ... dhe një jetë për ta harruar atë !!!

Thënie të mençura

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

9	1	2	4	16	17	17	18	V	O	T	6	A	T	E	R	S	F	P	E	M	I	L	E
11	3	2	5	4	18	6	5	18	3	2			R	A	K	T	R	E	B	E	L	E	T
9	6	9		9	10		2	18		2	1		U	P	E	R	I	O	D	I	K	K	E
8	1		9	11	1	3	1	3	2	5	2	3	D	I	N	A	S	T	I	A	D	E	T
17		12	4	1	3	2	6	1	8	2	6	1	R	E	P	A	R	T	E	N	I	R	A
7	4	10	3	2	6	12	3	1		14			G	E	R	E	R	E	K	K	I	R	K
13	6	12	5	2	3	9	4	1		11	6	18	P	A	R	E	T	T	R	U	K	E	T
14	6	2	4	9	1		4	10		1	12		I	U	I		G	O	A	L	K	R	A
18	11		4	7		4		7	4	13	3		R	L		P	A	R	I	M	E	T	B
2	6	7			3	1	10	6		6	2	2	O	L	T	I	T	A	N	E	I	L	A
6	15	2	3	9	3		4	1	6	12	4	6	G	E	U	N	I	T	E	T	V	I	T
16	5	12	3	7	4	13	6		9	3	6	1	A	K	R	A	M	E	R	G	A	T	I

- Mos dashuro dhe as mos urre, mos premo dhe as mos beso verbërisht.
- Nëse një ditë do të më kërkosh dhe nuk do të ekzistoj më... vetëm mos

- Mos u ndjeni keq kur kujtoni momentet e mira që kanë kaluar. Gëzohuni që dikur ekzistonin.
- Bëni gjithmonë atë që dëshironi, por të jeni, para së gjithash njerëz që dinë se ç'dëshirojnë.

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

T	E	R	A	P	I	A	K	B	E	V	A	
A	P	A	R	A	T	I	U	R	A	N	I	A
L	I	T	A	T	I	T	A	N	E	T		
I	K	T	A	T	R	I	V	A	L	E	T	
A	K	K	A	P	O	T	A	T	I			
M	A	R	A	T	O	N	E	O	D	T		
D	O	L	L	A	R	I	E	L	E	R		
K	S	I	A	K	A	D	E	M	I	A		
A	L	E	M	D	E	T	I	O	R	T		
M	A	E	L	E	T	I	E	N	E			
P	O	N	T	I	A	C	L	I	Q	E	N	I
I	S	H	T	A	T	I	A	D	E	T	E	T

FJALËKRYQI (2)

A	T	E	L	E	T	P	A	T	E	K			
R	E	A	A	K	D	A	L	A	T	U			
M	O	T	K	A	P	E	R	I	T	A	L	E	T
A	R	I	A	P	E	R	I	M	E	T	R	I	
T	E	N	S	E	R	E	N	A	T	A	T		
I	M	P	E	L	I	K	A	N	I	R	A		
M	E	M	O	E	M	E	T	U	B				
E	A	L	E	T	E	T	E	N	T				
T	E	T	A	R	I	A	L	E	A	T			
M	A	R	I	A	N	A	N	A	K	A			
T	I	N	C	T	I	A	T	I	P	A	R		
R	R	E	I	H	I	T	A	A	R	T	E		

